

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5499
E hënë, 11 qershor 2018
çmimi 0.40 €

Pas aksidenteve të fundit me fatalitet, policia apelon për kujdes në trafik | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ME NDERIME TË LARTA SHTETËRORE ËSHTË VARROSUR TË DIELËN NË PRISHTINË KRYETARI I FEDERATËS SË FUTBOLLIT TË KOSOVËS, FADIL VOKRRI | FAQE 3

LAMTUMIRË, LEGJENDË!

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), ish-futbollisti i Prishtinës, Partizanit, Fenerbaçes dhe reprezentacionit të ish-Jugosllavisë, Fadil Vokrri, është varrosur të dielën me nderime të larta shtetërore në Prishtinë, pas një sulmi që pësoi në zemër të shtunën në mëngjes. Në ceremoninë e varrimit kanë marrë pjesë zyrtarë të

lartë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, përfaqësues të partive politike, zyrtarë e udhëheqës të klubeve sportive nga rajoni e më gjerë, sportistë dhe qytetarë. Figura e Vokrit gjatë karrierës së pasur futbollistike dhe së fundmi si kryetar i FFK-së është vlerësuar lart nga drejtuesit e shtetit të Kosovës dhe më gjerë



AKTUALE

TALAT XHAFERI MBAN FJALIM NË PRIZEREN | F. 11



Ismet SYLEJMANI

DEPUTETËT DUHET TË DINË ÇFARË PËRFITON KOSOVA NGA NDËRTIMI I TERMOCENTRALIT TË RIË | F. 11



Gazmend ABRASHI

HARADINAJ: ÇËSHTJET ME SERBINË ZGJIDHEN ME NJOHJE, JO ME PAZARE POLITIKE | F. 3

KOSOVA DHE SHQIPËRIA KOORDINOHEN PËR THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT NË ARSIMIN E LARTË | F. 6

EKONOMI

KUSHTËZIMI, E VETMJA FORMË PËR T'I PAGUAR BORXHET NDAJ SHTETIT | F. 8

TË HYRAT BUXHETORE ARRIJNË VLERËN 362 MILIONË EURO | F. 9

SPORT

YVESA ISLAMI DHE REDON QERIMI RRËMBEJNË MEDALJE NË MAQEDONI | F. 20



ME AKTIVITETE TË NDRYSHME ËSHTË SHËNUAR 140-VJETORI I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Lidhja e Prizrenit dëshmoi ekzistencën e kombit shqiptar

Po të mos ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk do të ishte as 28 Nëntori dhe as 17 Shkurti. Kështu është thënë të dielën nga liderët shtetërorë në seancën solemne të Kuvendit të Kosovës me rastin e shënimit të 140-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të mbajtur në Prizren. Sipas tyre, pa Lidhjen e Prizrenit rrjedha e historisë kombëtare do të ishte krejtësisht ndryshe dhe aspak pozitive për kombin tonë | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta: Për negociata nevojitet bashkëpunim

Tiranë, 10 qershor - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka çelur sezonin turistik në zonën e Pustecit dhe liqenin e Prespës, bashkë me autoritetet vendore. Meta tha për mediet se kërkon bashkëpunim të palëve politike në vend në funksion të integritimit. "Unë besoj se janë të gjitha mundësitë që vendi ynë të

ketë sukses duke marrë një mesazh pozitiv. Këshilli i vendeve anëtare të BE-së, në mbështetje të rekomandimit pozitiv të KE-së dhe për këtë të gjithë duhet të punojmë të angazhohemi për mirë, për pritshmëritë jo vetëm të partnerëve tanë, por edhe të këshilltarëve në mënyrën më të përgjegjshme dhe

bashkëpunuese, jashtë çdo fryme konfliktuale dhe përjashtimi artificial", deklaroi ai.

Për sa i përket turizmit, Meta premtoi se disa ditë të pushimeve të tij verore do t'i bëjnë liqenin e mrekullueshëm të Prespës, duke theksuar se më përparësi ka zhvillimi dhe promovimi i turizmit në këto zona.



Ligji për gjuhën shqipe pret zgjedhjet e reja presidenciale?

Bazuar në qëndrimin e fortë të presidentit maqedonas Gjorgje Ivanov, nuk përjashtohet mundësia që Ligji për gjuhën shqipe të mos dekretohet deri në fund të mandatit të tij, vitin e ardhshëm

SHKUP, 10 QERSHOR - Ligji për përdorimin e gjuhëve të bashkësive etnive vazhdon të zvarritet për shkak të refuzimit të presidentit të Maqedonisë, Gjorge Ivanov, për ta dekretuar zgjidhjen e miratuar nga shumica parlamentare, më 14 mars.

Bazuar në qëndrimin e fortë të presidentit nuk përjashtohet mundësia që ligji të mos dekretohet deri në fund të mandatit të tij, vitin e ardhshëm. Ndërsa, një gjë të tillë nuk e kanë përjashtuar edhe partitë në pushtet, të cilat thonë se nuk po gjejnë mekanizëm juridik për fuqizimin e ligjit, me të cilët avancohet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në të gjitha institucionet e nivelit qendror, përkaj atyre në nivel lokal ku shqipja përdorej me zgjidhjen e deritanishme ligjore. Vendimi mund të fuqizohet, apo të shpallet në gazetën zyrtare vetëm nëse nënshkruhet nga kreu i shtetit dhe kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, por ky i fundi ka përjashtuar mundësinë që të vë firmën e tij pa atë të presidentit, për shkak se një veprim i tillë paraqet shkelje ligjore apo se edhe vetë institucioni "Gazeta Zyrtare" nuk do ta publikonte. Ekspertët thonë se partitë sikur nuk janë shumë të përkushtuar

për të gjetur zgjidhjen, me qëllim lënien e rastit deri në zgjedhjet e reja presidenciale. "Derisa vetë kryeparlamentari tha se pret hapësirë politike për të vepruar, del se është e vërtetë se ligji do të mbetet për më vonë. Por, kjo në aspektin ligjor është e padrejtë pasi nuk ka asnjë pengesë për zvarritjen e tij, pasi që nga momenti që është miratuar ai duhet të dekretohet", thotë Bashkim Selmani, njohës i çështjeve juridike.

Edhe Vllado Dimovski, njohës i çështjeve ndëretnike, thotë se partitë duhet të gjejnë mënyra për të mbyllur këtë çështje që të mos mbetet pas zgjedhjeve presidenciale. "Ligji për përdorimin e gjuhëve vlerësoj se deri tani duhet të mbyllet pasi ishte ngritur shumë pluhur deri në miratimin e tij, madje kishte edhe reagime, protesta e pakënaqësi të shumta. Mendoj se janë harxhuar të gjitha mekanizmat dhe ligji duhet të hyjë në fuqi. Por, si duket partitë mendojnë ndryshe, apo sikur kjo u konvenon që këtë çështje të ndjeshme sërish ta shfrytëzojnë për pikë politike në zgjedhjet e ardhshme presidenciale", thotë Dimovski duke shtuar se çështja e gjuhës është e ndjeshme dhe nuk duhet të



keqpërdoret nga partitë për qëllime politike. "Mendoj se kjo çështje duhet të mbyllet që të mos lihet e pazgjidhur për t'u keqpërdorur në zgjedhjet e ardhshme, ashtu siç ka ndodhur edhe në të kaluarën me çështjet që kanë të bëjnë me raportet ndëretnike. Marrëdhëniet ndëretnike në vend ende janë të brishta dhe shumë pak nevojitet që ato të marrin përmasa të paparashikuara, andaj duhet të kenë kujdes që të mos luhet me gjëra të ndjeshme. Pra, vlerësoj se çështja e gjuhës nuk duhet të keqpërdoret nga partitë për pikë politike", thotë Dimovski. Nga ana tjetër, Bashkim Selmani

thotë se përdorimi i gjuhës shqipe është i garantuar dhe se partitë, sipas tij, këtë çështje e kanë keqpërdorur vite me radhë për qëllime politike. "Është dëm shumë i madh pasi humbet e drejta jetike, një e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Mendoj se pak kanë rëndësi format e abuzimit në aspektin juridik apo sa partitë tentojnë të përfitojnë. Por, këtu kemi një situatë kur e drejta natyrore cunohet dhe ky është dëshpërimi më i madh të qytetarët. Me këtë edhe partitë shqiptare kanë humbur, pasi kanë rrënuar imazhin e tyre, qoftë pozita apo opozita, pasi kanë nënshkruar një kapitullim

total, moral, politik, juridik e kështu me radhë", thotë Selmani.

Përveç presidentit, Ligji për gjuhët kundërshtohet edhe nga VMRO-DPMNE-ja opozitare e cila kishte organizuar edhe protesta me arsyetimin se zgjidhja e miratuar rrënon karakterin unitar të shtetit ku, sipas kësaj partie, gjuhë zyrtare në shtet është vetëm maqedonishtja. Por, partitë shqiptare kanë thënë se qëndrimi i opozitës maqedonase, pavarësisht prej ndryshimeve në kreun e saj, po dëshmon se kur janë në pyetje shqiptarët, nuk dallon nga udhëheqësja e kaluar.

Qeveria maqedonase: Nuk ka përçarje rreth çështjes së emrit

SHKUP, 10 QERSHOR - Nuk ka përçarje mes kryeministrit Zoran Zaev dhe ministrit Nikola Dimitrov lidhur me zgjidhjen e çështjes për emrin.

Ky është reagimi nga Qeveria maqedonase pas shkrimeve në media të nxitura edhe nga persona zyrtarë të Greqisë, se bisedimet janë zvarritur për shkak të dallimeve në kreun politik të

Maqedonisë për versionin përfundimtar të marrëveshjes. "Kryeministri Zoran Zaev, ministri i Jashtëm Nikola Dimitrov dhe për-bërja e plotë e Qeverisë së Maqedonisë janë në një linjë të vetme, fuqishëm të përcaktuar dhe të përkushtuar në tejkalimin e kontesteve, përforcimin e dinjitetit dhe identitetit të qytetarëve të Maqedonisë", ka deklaruar Mile

Boshnjakovski, zëdhënës i Qeverisë së RM-së.

Këtij reagimi i paraprijnë disa shkrime, ku cak i sulmeve ishte ministri i Jashtëm Nikolla Dimitrov. Ai u akuzua se ka luajtur lojëra të dyfishta, ndërsa përmendej edhe prejardhja e tij nga Egjeu dhe se në të kaluarën ka qenë i afërt me VMRO-DPMNE-në "nacionaliste".



Haradinaj: Çështjet me Serbinë zgjidhen me njohje, jo me pazare politike

Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se e vetmja mënyrë që të përbyllet çështja në mes të Kosovës dhe Serbisë është pajtimi mes dy popujve dhe njohja reciproke ndërmjet dy vendeve. Ai ka theksuar se çështjet e pazgjidhura me Serbinë po përpiqen t'i zgjidhin me pazare të reja politike dhe, sipas Haradinajt, është e padrejtë të ndodhë një gjë e tillë. Megjithatë, kryeministri i ka siguruar qytetarët e Kosovës se nuk do të ketë më pazare të ndyta në dëm të shqiptarëve



Prizren. Ndërkohë që, Kosova është në fazën finale të dialogut me Serbinë të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe i mbështetur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Procesi i dialogut synohet të përbyllet me një marrëveshje ligjërish të obligueshme për të

dyja palët, që nënkupton njohjen e ndërsjellët në mes të Kosovës dhe Serbisë. Për këtë fazë të dialogut Kosova ka hartuar një platformë shtetërore e cila ka për qëllim kryesor arritjen e një uniteti politik në mes të partive në pushtet dhe atyre në opozitë për procesin e dialogut

me Serbinë. Megjithatë, deri më tani partitë politike në pushtet dhe ato në opozitë ende nuk kanë arritur t'i përafrojnë qëndrimet e tyre lidhur me këtë çështje. Në mungesë të konsensusit, javën e kaluar Qeveria është detyruar ta tërheqë nga Kuvendi këtë platformë.

**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije të dielën se shteti i Kosovës gjendet në një periudhë të ndjeshme pasi, siç është shprehur ai, çështjet e pazgjidhura me Serbinë po synohet të zgjidhen me pazare të reja politike. Por, Haradinaj i ka siguruar qytetarët e Kosovës se nuk do të ketë më pazare të ndyta në dëm të shqiptarëve dhe se mënyra e vetme që të përbyllet lufta e vitit 1998-1999 me Serbinë është pajtimi në mes dy popujve dhe njohja reciproke ndërmjet dy vendeve. "Ju siguroj se te shqiptarët asnjëherë nuk do të ketë mungesë të atyre që do të mendojnë për fatin e vet, për të drejtën e vet në të gjitha

kohët. Edhe sot i kemi kohëra të ndjeshme. Një marrëdhënie e pambyllur Kosovë - Serbi po synohet të kthehet në pazare të reja politike dhe kjo është e padrejtë të ndodhë. Me këtë rast ju siguroj se mënyra e vetme që të përbyllet një luftë në mes të Kosovës dhe Serbisë, lufta e vitit 1999 e cila i ka lënë Kosovës shumë plagë, masakra, njerëz të vrarë, shkatërrime dhe këtë objekt të djegur, është një pajtim mes shqiptarëve e serbëve me njohje në mes të Kosovës dhe Serbisë pa pazare të tjera të ndyta në dëm të shqiptarëve", ka deklaruar Haradinaj.

Këto komente kryeministri Ramush Haradinaj i ka bërë në seancën solemne të Kuvendit të Kosovës me rastin e shënimit të 140-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të mbajtur në

Pas aksidenteve të fundit me fatalitet, policia apelon për kujdes në trafik

**EPOKA
ERE** **Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Policia e Kosovës (PK) ka apeluar tek të gjithë pjesëmarrësit në trafik, në veçanti tek drejtuesit e automjeteve, që ta rrisin nivelin e vetëdijes, ta shtojnë kujdesin dhe vigjilencën e tyre gjatë drejtimit të automjeteve të tyre. Sipas policisë, me veprimet e tyre jo vetëm se po rrezikojnë jetët e tyre, por po rrezikojnë edhe jetët e pjesëmarrësve të tjerë në trafikun rrugor. "Referuar shtimit të numrit të aksidenteve me pasoja fatale, veçanërisht dy rasteve të fundit të aksidenteve (vetaksidenteve) tragjike në trafikun rrugor, njëri në rajonin e Ferizajt (8. 6. 2018) dhe tjetri gjatë natës së mbrëmshme (10. 6. 2018) në rajonin e Pejës, ku në të dyja rastet kanë humbur jetën gjashtë persona, kërkohet nga drejtuesit e automjeteve, t'i respektojnë dispozitat ligjore, sinjalistikën rrugore, t'u përshtaten kushteve të rrugës, të mos drejtojnë automjetet derisa janë në ndikim të lodhjes, gjumit apo

nën ndikim të alkoolit, t'i shmangen përdorimit të telefonit gjatë ngasjes si dhe veprimeve të tjera që mund të shkaktojnë rrezik dhe pasiguri gjatë drejtimit të automjetit", thuhet në komunikatën e policisë. Sipas PK-së, humbja e jetëve të qytetarëve në aksidente trafiku është shqetësuese jo vetëm për policinë, por edhe për institucionet e tjera dhe qytetarët në përgjithësi. "Prandaj, kërkohet një përkushtim dhe qasje më gjithëpërfshirëse proaktive. Njësitë policore po vazhdojnë të monitorojnë dhe ta menaxhojnë situatën në trafikun rrugor nëpër të gjitha rrugët e vendit dhe aty ku pjesëmarrësit bien ndesh me rregullat që parasheh ligji në trafik, masa ndëshkuese ligjore do të aplikohen në vazhdimësi me qëllim të parandalimit të rasteve të aksidenteve, në veçanti këtyre me pasoja fatale", thuhet në këtë komunikatë.

Policia e Kosovës ka njoftuar se, përveç detyrave aktive për mbajtjen e rendit dhe zbatimin e ligjit, angazhime intensive me zyrtarët e saj ka edhe në menax-



himin dhe kontrollin e trafikut rrugor dhe në baza ditore shqipton rreth 1 000 tiketa për kundërvajtje në trafik. "Prapëseprapë sit-

uata në trafikun rrugor mbetet shqetësuese dhe kërkon qasje serioze nga të gjithë, si dhe ndërmarrje të veprimeve efektive për

vetëdijesim me qëllim të parandalimit të humbjes së jetëve njerëzore", është theksuar në komunikatën e Policisë së Kosovës.

Me nderime të larta shtetërore është varrosur të dielën në Prishtinë kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil

LAMTUMIRË, LE

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), ish-futbollisti i Prishtinës, Partizanit, Fenerbaçes dhe reprezentacionit të ish-Jugosllavisë, Fadil Vokrri, është varrosur të dielën me nderime të larta shtetërore në Prishtinë, pas një sulmi që pësoi në zemër të shtunën në mëngjes. Në ceremoninë e varrimit kanë marrë pjesë zyrtarë të lartë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, përfaqësues të partive politike, zyrtarë e udhëheqës të klubeve sportive nga rajoni e më gjerë, sportistë dhe qindra qytetarë. Figura e Vokrrit gjatë karrierës së pasur futbollistike dhe së fundmi si kryetar i FFK-së është vlerësuar lart nga drejtuesit e shtetit të Kosovës dhe më gjerë

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Legjendës së futbollit shqiptar, Fadil Vokrrit, i është dhënë të dielën lamtumira e fundit në varrezat e lagjes "Arbëria" në Prishtinë. Në ceremoninë shtetërore të organizuar nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në homazhe

një njeriu të ndershëm të Kosovës dhe sinonim të shpresave dhe sukseseve. "Fadili ishte sinonim i gëzimeve tona, ishte sinonim i lajmeve të mira për Kosovën, ishte sinonim i gjërave të bukura të vendit tonë, sinonim i shpresave për një Kosovë që bën historinë në fushën e gjelbër të sportit më të bukur në botë, futbollit. Para së gjithash, Fadil Vokrri ishte sinonim i njeriut të ndershëm të

gola për ta nderuar vendin tonë dhe kujtimin e heroit të futbollit tonë, Fadil Vokrrit", ka deklaruar Veseli.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj e ka vlerësuar lart figurën e Fadil Vokrrit. Shefi i ekzekutivit ka thënë se falë kryetarit tashme të ndjerë të FFK-së, Kosova është pjesë e familjes evropiane dhe botërore të futbollit. "Fadil Vokrri ishte i të gjithëve. Ai e kishte shpirtin e bardhë. Ishte një sportist shpirtbardhë dhe gjithmonë u gëzohej lajmeve të mira. Falë tij, Kosova u kthye në familjen e futbollit. Ai na bëri shumë miq për sportin dhe për vendin tonë. Sot nuk është në dhimbje vetëm familja. Lavdi jetës dhe punës së madhe që ka bërë për sportin dhe për ne Fadil Vokrri", ka thënë Haradinaj.

Ndërsa në emër të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) ka folur sekretari i përgjithshëm i kësaj federate, Eroll Salihu. Ky i fundit e ka vlerësuar Vokrrin si më meritin për pranimin e FFK-së në UEFA dhe FIFA, kurse më pas ka thënë se Vokrri ka qenë sinonim i futbollit dhe sportit të Kosovës. "Atij me të drejtë i atribuohet suksesi për anëtarësimin e FFK-së në UEFA dhe FIFA. Ne nuk është dashur të jemi këtu sot, por të udhëtojmë drejt Rusisë për ta pritur fillimin e ngjarjes më të madhe sportive, Kampionatin Botëror. Fadil Vokrri na la me



thjeshtësinë e pashoqe që e karakterizoi. Jepte gol dhe ecte tutje, publiku e përgëzonte, por ai gjithmonë qëndronte pa mburrje dhe pa u lëvdur. Sukseset e tij janë përcjell me brohoritje dhe vlerësim. Emri i tij ka hapur rrugë edhe pa praninë e tij fizike. Kurse vendin e tij në zemrat e njerëzve e ka fituar që kur kaloi kufijtë me talentin dhe suksesin e tij duke u dhënë dinjitet të gjithë futbollistëve. Nëse sot anekënd botës kemi yje, pa dyshim se Vokrri

kishte rol duke përfaqësuar një ëndërr që ai e kishte realizuar. Ka qenë dhe do të mbetet sinonim i futbollit dhe i sportit të Kosovës. Ngushëllime më të thellë në emër të FFK-së! U prehsh në paqe, president", ka thënë Salihu.

Figurën e Vokrrit e vlerësuan lart edhe kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani dhe kryetari i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka. Ndërsa në emër të familjes foli djali i Fadil Vokrrit, Gramozi, i cili, pasi ka falënderuar të gjithë për mbështetjen e dhënë, ka thënë se babai i tij nuk ishte vetëm i familjes, por i gjithë Kosovës. "Të nderuar drejtues të institucioneve shtetërore të Kosovës, drejtues të Federatës së Futbollit, familjarë dhe dashamirë, është jashtëzakonisht e vështirë ta përshkruaj babin tim, por besoj se vepra e tij flet vetë. Falënderoj për përkrahjen e vazhdueshme që na keni bërë, pasi Fadil Vokrri nuk ishte vetëm i yni, por i gjithë Kosovës. I qoftë i lehtë dhe i Kosovës!", ka thënë Vokrri.

Fadil Vokrri lindi më 23 korrik të vitit 1960 në Podujevë, kurse pas vetes la bashkëshorten, Editën dhe tre fëmijët, djemtë Gramozin e Albertin dhe vajzën, Albanën.



kanë marrë pjesë zyrtarë të lartë nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia, përfaqësues të partive politike, zyrtarë e udhëheqës të klubeve sportive nga rajoni e më gjerë, sportistë dhe qindra qytetarë, si dhe legjenda e skuadrës së Milanit dhe Kroacisë, Zvonimir Boban.

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokrri, ka ndërruar jetë papritmas të shtunën paradite në moshën 57-vjeçare si pasojë e një sulmi në zemër. Pikëllimi për humbjen e legjendës së futbollit ishte i madh në gjithë vendin, kurse të shtunën në mbrëmje në Sheshin "Skënderbeu" në kryeqytet nga qytetarë të shumtë dhe njerëz të komunitetit sportiv janë ndezur qirinj në shenjë respekti dhe kujtimi të veprimtarisë së kryetarit të FFK-së, Fadil Vokrri.

Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ditën e diel e shpalli ditë zi.

Në akademinë përkujtimore të mbajtur në sallën e Kuvendit të Kosovës, me rastin e vdekjes së legjendës së futbollit të Kosovës, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, e ka vlerësuar Vokrrin si sinonim të

Kosovës, prandaj dhimbja është e madhe. Humbja, po ashtu. Një humbje kombëtare. Kemi humbur legjendën e futbollit tonë, në kohën kur më së shumti kërkohej përkushtimi, profesionalizmi dhe atdhedashuria sportive e tij. Ne do ta vazhdojmë ëndrrën e tij, duke mundësuar që të rinjtë e Kosovës të luajnë në kampionatet e futbollit botëror, të shënojnë



Vokrri

'GJENDË!



Nga jetëshkrimi i Fadil Vokrrit

Fadil Vokrri lindi më 23 korrik të vitit 1960 në Podujevë. Me futboll nisi të merret si 15-vjeçar, kurse si 17-vjeçar debutoi në KF "Llapi" në Podujevë. Më pas, në vitin 1980, kaloi te KF "Prishtina", ku luajti 84 ndeshje dhe shënoi 33 gola me këtë skuadër në Ligën e Dytë, kurse në Ligën e Parë të Jugosllavisë me fanellën e Prishtinës pati 88 paraqitje dhe realizoi 22 gola. Periudha e viteve të '80 -ta ishte e artë për Vokrrin, i cili në vitin 1984 debutoi në ekipin përfaqësues të Jugosllavisë, duke u bërë futbollisti i vetëm shqiptar që u paraqit në Përfaqësuese, e ku regjistroi 12 paraqitje dhe shënoi 6 gola. Në vitin 1986 u transferua te Partizani i Beogradit, ku në 27 ndeshje shënoi 13 gola. Ai me meritë e fitoi epitetin e legjendës së futbollit kosovar, pasi ishte bartës i flamurit olimpiq në Lojërat Olimpikë Dimërore në Sarajevë në vitin 1984, ndërsa në vitin 1987 ishte shpallur lojtari më i mirë në Jugosllavi. Në vitin 1989 kaloi në Francë te skuadra Nimes, më pas u transferua në klubin turk Fenerbahçe, ku luajti me



mjaft sukses në edicionet 1990-1992. Pas karrierës në kampionatin turk ai u rikthye në Francë, ku jetoi me familjen dhe luajti edhe për disa vjet për skuadrat e niveleve më të ulëta franceze, Bourges dhe Montluçon, para se t'i jepte fund karrierës. Pas çlirim-it të Kosovës u kthye në atdhe, fillimisht për ta ndihmuar ish-klubin e tij, Prishtina, në postin e drejtorit, kurse më pas, në shkurt të vitit 2008, mori timonin e Federatës së Futbollit të Kosovës

si njeriu më i duhur për ta drejtuar FFK-në drejt anëtarësimit në UEFA e FIFA. Më 15 janar 2016 Vokrri iu besua mandati i tretë katërvjeçar si president i FFK-së. Ai ishte i diplomuar në Fakultetin e Menaxhmentit dhe Biznesit, kurse përveç gjuhës amtare zotëronte edhe gjuhët frënge, turke dhe serbo-kroate. I ndjeri pas vetes la bashkëshorten, Editën dhe tre fëmijët, djemtë Gramozin e Albertin dhe vajzën, Albanën.

REAGIMET PËR VDEKJEN E FADIL VOKRRIT

Hashim Thaçi, president i Kosovës: "Me dhimbje të madhe dhe pikëllim të thellë i tërë kombi mori lajmin për vdekjen e parakohshme të Fadil Vokrrit, yllit më të ndritur të sportit dhe jo vetëm sportit tonë. Ngushëllime familjes, miqve dhe tifozëve! U prehsh në paqe, Kapiten!"

Ilir Meta, president i Shqipërisë: "Ndarja e parakohshme nga jeta e legjendës së futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, është një lajm shokues për të gjithë shqiptarët që e kanë ndjekur e adhuruar shkëlqimin e talentit të tij si sulmues e golashënues i Prishtinës, por edhe ekipeve të njohura evropiane të Partizanit të Beogradit, Fenerbahçes, madje edhe të përfaqësueses së ish-Jugosllavisë. Fadil Vokrri me talentin dhe suksesin e tij frymëzoi shumë fëmijë shqiptarë kudo për të ecur në shembullin e tij. Me personalitetin e tij ndërkombëtar ndihmoi integrimin e Kosovës në UEFA dhe FIFA. Pak ditë më parë pata kënaqësinë ta firmosja dhënien e shtetësisë shqiptare për Fadil Vokrrin me kërkesë të FShF-së për kontributin e tij të veçantë në mbështetje të futbollit tonë, sidomos të ekipeve kombëtare".

Kujtim Gashi, ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit: "Tërë shqiptarët anekënd Botës kanë humbur një legjendë, me të cilin jemi mishëruar dhe kemi gjetur veten tek ai kur shënonte gola e korrtë fitore. Me angazhimin e tij, me një përkushtim të paepur ka bërë që emri i tij të jetë i gdhendur thellë në botën e futbollit duke tejkaluar dhe thyer çdo barrierë për ta shndërruar veten në një yll që bota e futbollit do ta kujtojë dhe s' do ta harrojë kurrë. Ai me sukses ka udhëhequr Federatën e Futbollit të Kosovës, duke kurorëzuar edhe në ndërkombëtarizimin e futbollit të Kosovës, me anëtarësim në UEFA e FIFA".

Gianni Infantino, presidenti i FIFA-s: "Fadil Vokrri ka qenë një pionier në shumë mënyra dhe ka arritur një karrierë të madhe ndërkombëtare, duke luajtur në klube e liga të ndryshme të nivelit të lartë, në një kohë kur nuk ishte aq e zakonshme sa sot. Hodhi themelet për anëtarësimin e Kosovës në FIFA. Kjo ka kërkuar energji të jashtëzakonshme,

besim, forcë dhe bindje. Fadili i kishte të gjitha. Ai ishte njeri shembull i entuziazmit, energjisë dhe një udhëheqës i madh. Jam krenar që e kam njohur dhe kam punuar me të".

Aleksandër Çeferin, president i UEFA-s: "Jemi të tronditur dhe shumë të pikëlluar që dëgjuam për humbjen e Fadil Vokrrit. Ai ishte një futbollist i shquar që gëzonte një karrierë të shquar dhe u bë administrator i futbollit dhe president i shoqatës kombëtare të kalibrit më të lartë. Fadili ishte figura kryesore në zhvillimin e futbollit të Kosovës që çoi Federatën e Futbollit të Kosovës për t'u bërë anëtar i UEFA-s në 2016. Në periudhën që prej atëherë, ai kishte udhëhequr integrimin e federatës brenda UEFA-s me aftësi dhe angazhim të madh".

Shoqata e Gazetarëve Sportivë të Kosovës: "Kosova humbi njëherën ndër figurat më të shquara të saj jo vetëm në sport, por në të gjitha sferat e jetës, një ambasador, një njeri që me veprimtarinë e tij jetësore e bëri gjithë botën të fliste për ne. Në këto momente të rënda për familjen, ShGSK-ja qëndron afër saj dhe u shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjarëve dhe gjithë qytetarëve të Kosovës. U prehsh në paqe, legjendë!"

Federata e Shqiptare e Futbollit: "Fadil Vokrri vuri gjithçka në dispozicion të rritjes dhe zhvillimit të futbollit në Kosovë. Kontributi i Presidentit Vokrri do të mbahet mend shumë gjatë për angazhimin e tij maksimal dhe gjithëpërfshirës në drejtim të ngritjes dhe përfaqësimit ndërkombëtar të Kosovës dhe futbollit të saj, në Evropë dhe në Botë. Ndarja e tij e parakohshme nga jeta mbetet një humbje shumë e madhe për futbollin kosovar, por edhe për të gjitha trevat shqipfolëse anembanë botës".

Adil Vokrri, vëlla i Fadilit: "Fadil, ti ishe aq i madh sa ikja e jote ka tronditur jo vetëm botën shqiptare, dhe lotët që po e sheh si lumë në fytyrat e njerëzve më bëhet sikur është shembur bota jo vetëm për ne, por për të gjithë. Ike kur kishe edhe shumë për të bërë dhe për të na dhënë. Thonë se koha shëron plagët, por unë nuk besoj në këtë, sepse kjo do të na i shtojë plagët. Pikëllimi dhe malli për ty, vëlla, do të na mbetet për jetë".

Kosova dhe Shqipëria koordinohen për thellimin e bashkëpunimit në arsimin e lartë

Ministri i Arsimit i Kosovës, Shyqyri Bytyqi dhe ministrja e Arsimit e Shqipërisë, Lindita Nikolla, kanë mbajtur të dielën një takim të përbashkët në qytetin e Prizrenit, në të cilin janë pajtuar për thellimin e bashkëpunimit për harmonizimin e punëve të institucioneve të arsimit të lartë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRIZREN, 10 QERSHOR - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve e Shqipërisë, në kuadër të angazhimeve të përbashkëta për thellim të bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe në kuadër të shënimit të 140-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit dhe vitit jubilar të Skënderbeut, dy data të rëndësishme në historinë e vendeve tona, kanë mbajtur të dielën një takim të përbashkët në qytetin e Prizrenit.

Ministri i Arsimit i Kosovës, Shyqyri Bytyqi dhe ministrja e Arsimit e Shqipërisë, Lindita Nikolla, fillimisht kanë mbajtur takim me drejtuesit e Institutit të Albanologjisë të Kosovës dhe atij të Shqipërisë dhe të Institucioneve të Historisë, me qëllim të harmonizimit dhe bashkëpunimit të këtyre institucioneve të rëndësishme. Ministri Bytyqi me këtë rast ka shprehur mirënjohjen e thellë për punën dhe veprimtar-

inë e instituteve të albanologjisë dhe historisë dhe është zotuar se do të mbështesë çfarëdo vendimi që del nga takimi i drejtuesve të këtyre instituteve. Ai ka thënë se është angazhim i përbashkët i dy ministrive që të gjejnë forma të thellimit të bashkëpunimit të instituteve, në mënyrë që të kenë një kalendar të përbashkët të punës dhe veprimtarive të tyre. Ndërsa në takimin që mbajtën të dy ministrat me rektorët e universiteteve publike të Kosovës dhe Shqipërisë u diskutua për mobilitetin e profesorëve për programe të rëndësishme, por që janë në rrezik të mbylljen në mungesë të kuadrove si dhe për mundësinë e rritjes së kuadrove për studentët kosovarë dhe anasjelltas për pranim në programe të avancuara.

Ministri Bytyqi ka thënë se me ministrin Nikolla po vazhdojnë takimet për thellimin e bashkëpunimit për harmonizimin e punëve të institucioneve të arsimit të lartë. "Universitetet tona kanë pasur bashkëpunim të vazhdueshëm qoftë për



mobilitetin e studentëve, qoftë të profesorëve por këtu, bashkë me ministrin Nikolla, jemi që edhe si qeveri t'ju mbështesim dhe të çojmë më tutje këtë bashkëpunim. Nga ky takim do të dalin diskutime të rëndësishme dhe hapa konkretë për tri temat e rëndësishme për të cilat me ministrin jemi pajtuar në Tiranë", ka thënë ministri Bytyqi. Ai ka theksuar se duke parë situatën ekzistuese në Universitetin e Prishtinës dhe atë të Tiranës, sa i përket rrethikshmërisë së mbylljes së disa programeve në mungesë të kuadrove, është menduar të mer-

ren obligime për hartimin e politikave në realizmin e këtij mobiliteti, në mënyrë që këta profesorë të njihen si profesorë të rregullt.

Ndërsa ministrja e Arsimit e Shqipërisë, Lindita Nikolla, ka thënë se ekziston vullneti maksimal i të dy qeverive për ta mbështetur bashkëpunimin në arsimin e lartë dhe për të adresuar një agjendë të përbashkët veprimi. Në këtë takim u fol edhe për organizimin e një kompleksi veror tradicional për studentët e të gjitha viseve shqiptare. Në fund, ministri

Bytyqi dhe ministrja Nikolla, në konferencën e mbajtur me gazetarë, thanë se unifikimi i programeve parauniversitare në mes të Kosovës dhe Shqipërisë po vazhdon edhe me harmonizimin e çështjeve të arsimit të lartë dhe punën e instituteve. Ata theksuan se të dy qeveritë janë të gatshme për të qenë një krahë i fortë mbështetës për universitetet dhe së bashku të adresojnë standarde të larta profesionale në arsimin e lartë, për të qenë pjesë dinjitoze në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

Vendosen pllaka në shtëpitë që shërbyen si baza të UÇK-së

VITI, 10 QERSHOR (ER) - Brigada 173 "Gursel e Bajram Sylejmani" e Zonës Operative të Karadakut ka vendosur pllaka në shtëpitë që kanë shërbyer si baza të UÇK-së gjatë luftës në Kosovë. Dy pllaka të tilla u përuruar në Smirë të Vitisë, në shtëpinë e Kemajl Demirit dhe të Feriz Ahmetit. Ish-komandanti i kësaj brigade, Selami Neziri - "Agroni", ka thënë se këto pllaka po vendosen për t'i identifikuar shtëpitë baza në shërbim të luftës. "T'i bësh konak në atë kohë UÇK-së nuk ka qenë fare e lehtë. Ata që kanë

pranuar që dikush me uniformë, i armatosur, me disa njerëz të hyjë në atë familje, e kanë llogaritur sakrificën më sublimë, qoftë edhe të shfaroset me gjithë familjen. Në këto dy shtëpi në Smirë gjatë luftës ka qëndruar komandanti i UÇK-së për Zonën Operative të Nerodimës, Shukri Buja", ka thënë Selami Neziri. Ai ka treguar se vitin e ardhshëm do të vendosen pllaka edhe në dy shtëpi të tjera në Smirë dhe kështu do të vazhdohet edhe në fshatra të tjera të Komunës së Vitisë. Familjarët e familjeve Demiri

dhe Ahmeti janë falënderuar për këtë mirënjohje që po u bëhet atyre për kontributin në shërbim të luftës.

Sejdi Ahmeti, pjesëtar i Brigadës 173 "Gursel e Bajram Sylejmani", ka thënë se këto pllaka po vendosen në disa fshatra të Komunës së Vitisë, me rastin e 20-vjetorit të fillimit të organizimit të luftës në Komunën e Vitisë. Pllaka që identifikojnë shtëpitë baza të UÇK-së janë vendosur edhe në Sllakovc, Zllatar, Ramjan, Pozheran, Sadovinë e Jerlive dhe Remnik.



Oorrolli: Vazhdimi i mandatit të EULEX-it, pamaturit e institucioneve të drejtësisë



PRISHTINË, 10 QERSHOR - Juristi Vigan Oorrolli ka thënë se vazhdimi i mandatit të EULEX-it edhe për dy vjet nënkupton pamaturinë e institucioneve vendore të drejtësisë. Sipas tij, kjo pamaturia do të thotë se, po të mos ishin prokurorët dhe gjyqtarët e huaj, drejtësia në Kosovë do të mbetej e

pakuptimtë. "EULEX-i plus 2 vjet! Vazhdimi i mandatit të EULEX-it edhe për dy vjet (deri më 2020) nënkupton, para së gjithash, pamaturinë e institucioneve vendore të drejtësisë. Krejt kjo për shkak se vendorët vazhdojnë të funksionojnë sipas një rregulli mizor, që njihet si frikë dhe pasiguri

në vendimmarrje. Kjo pamaturia do të thotë që po të mos ishin prokurorët dhe gjyqtarët e huaj, drejtësia në Kosovë do të mbetej e pakuptimtë. Është kështu fatkeqësisht dhe derisa të jetë kështu, EULEX-i do të jetë i domosdoshëm", ka shkruar Oorrolli në llogarinë e vet në "Facebook".

Me aktivitete të ndryshme është shënuar 140-vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Lidhja e Prizrenit dëshmoi ekzistencën e kombit shqiptar

Po të mos ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk do të ishte as 28 Nëntori dhe as 17 Shkurti. Kështu është thënë të dielën nga liderët shtetërorë në seancën solemne të Kuvendit të Kosovës me rastin e shënimit të 140-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të mbajtur në Prizren. Sipas tyre, pa Lidhjen e Prizrenit rrjedha e historisë kombëtare do të ishte krejtësisht ndryshe dhe aspak pozitive për kombin tonë



EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Me rastin e shënimit të 140-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka mbajtur seancë solemne në Prizren si dhe është vendosur gurthemeli i kompozicionit të shtatoreve të udhëheqësve të Qeverisë së Lidhjes së Prizrenit.

Me këtë rast, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se Lidhja e Prizrenit pati arritur qëllimin e saj, ndonëse me pasojë shumë të rënda, duke dëshmuar para fuqive evropiane ekzistencën e kombit shqiptar dhe mbrojtjen e të drejtave të tij. "140 vjet më parë në këtë vend u mblodhën përfaqësuesit e të gjithë trevave shqiptare. Një barrë e madhe qëndronte mbi supet e tyre. Ishte kohë e vështirë. Ballkani ishte i trazuar si asnjëherë më parë. Perandoria Osmane po jepte shenjat e rënies së pashmangshme. Popujt po zgjoheshin. Evropa po jetonte pranverën e kombeve. Secili kërkonte vendin dhe të drejtat e tij në gjeopolitikën e re që po ndërtohej. Ishte koha që edhe shqiptarët të zgjoheshin, sa më parë që ishte e mundur. Në këto rrethana të rënda, burrat e mbledhur në Prizren kishin përpara dy sfida të rënda historike: të dëshmonin

para fuqive evropiane dhe Perandorisë Osmane ekzistencën e kombit shqiptar, njëkohësisht t'i mbronin me çdo kusht të drejtat e tij legjitime politike. E udhëhequr nga diplomacia e Abdyl Frashërit, nga urtësia e Ymer Prizrenit dhe guximi luftarak i Sylejman Vokshit, Lidhja e Prizrenit arriti qëllimet e saj, ndonëse me pasojë shumë të rënda", është shprehur Veseli.

Ai ka vlerësuar se pa Lidhjen e Prizrenit nuk do të ishte 28 Nëntori dhe 17 Shkurti. "Lidhja e Prizrenit themeloi vetëdijen kombëtare shqiptare, krijoi standardet e patriotizmit modern shqiptar dhe platformën e programit për çlirim e pavarësi kombëtare. Pa lidhjen e Prizrenit nuk do ta kishim 28 nëntorin e vitit 1912. Pa lidhjen e Prizrenit nuk do ta kishim lëvizjen kombëtare për çlirimin e Kosovës, e cila arriti kulminacionin historik me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, çlirimin dhe shpalljen e pavarësisë në shkurtin e vitit 2008", ka deklaruar Veseli, duke shtuar se pa Lidhjen e Prizrenit rrjedha e historisë sonë kombëtare do të ishte krejtësisht ndryshe dhe aspak pozitive për kombin tonë.

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj, duke kujtuar Lidhjen e Prizrenit, ka thënë se burrat dhe Ymeri, Abdyl dhe Sylejmani, kanë punuar që

shqiptarët të vendosin një ditë për të drejtën e vet. "Popujt duhet të punojnë gjithnjë për kohë të vështira. Burrat e asaj kohe shihet se kishin menduar ndër vite se mund t'u vijë ajo ditë, që në ditë të caktuar edhe shqiptarët ta japin përgjigjen e tyre për të drejtën e tyre", ka thënë Haradinaj.

Ai ka theksuar se sot dhe për mot duhet të punojmë për një ditë të këtyllë dhe, sipas Haradinajt, në atë ditë të gjithë duhet të jemi aty për ta dhënë provimin tonë. "Ju siguroj se te shqiptarët asnjëherë nuk do të ketë mungesë të atyre që do të mendojnë për fatin e vet, për të drejtën e vet në të gjitha kohët. Edhe sot e kemi kohën e ndjeshme. Një marrëdhënie e pambyllur Kosovë-Serbi po synohet të kthehet në pazare të reja politike dhe kjo është e padrejtë

të ndodhë", ka theksuar Haradinaj.

Kurse presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se krijimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte vazhdim i Lidhjes së Lezhës të krijuar nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu shekuj më parë dhe shënonte në vete një kulminacion të rizgimit dhe të Rilindjes Kombëtare Shqiptare për ta shpalosur identitetin kombëtar dhe politik të komit tonë, për t'i legjitimuar aspiratat e tij për shtetformim dhe për t'ia bërë ato të ditura të gjithë botës. Ndërkaq, kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi, ka rikujtuar se Lidhja e Prizrenit ishte lëvizja e parë e madhe shqiptare e organizuar në mënyrë administrative, politike dhe ushtarake që nga koha e Skënderbeut të madh.

Thaçi: Lidhja Prizrenit iu kundërvu synimeve për copëtimin e tokave shqiptare

Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Lidhja Shqiptare e Prizrenit në formë të ndryshme iu kundërvu synimeve për copëtimin e tokave shqiptare. Ai ka vlerësuar se ideatorët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni, Sulejman Vokshi, edhe pas 14 dekadash mbeten figura të mëdha historike. "Lidhja Shqiptare e Prizrenit iu kundërvu synimeve për copëtimin e tokave shqiptare, pas dobësimit të Perandorisë Osmane me kryengritje, memorandumet dhe formë të tjera të rezistencës. Lëvizja kulturore e Rilindjes sonë Kombëtare, si vetëdije kulturore dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, si vetëdije politike, janë ngjarjet më të rëndësishme në historinë e kombit tonë në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Ideatorët, burrështetasit dhe ushtarakët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni, Sulejman Vokshi etj., mbeten figura të mëdha historike, frymëzuese edhe pas 14 dekadash", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



Kushtëzimi, e vetmja formë për t'i paguar borxhet ndaj shtetit



Autoritetet në Kosovë po praktikojnë kushtëzimin për qytetarët që t'i paguajnë gjobat apo borxhet për shërbimet komunale që këta të fundit kanë ndaj shtetit. Janë miliona euro borxhe dhe mijëra gjoba për kundërvajtje në trafik që qytetarët kanë të papaguara

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka njoftuar qytetarët se duke filluar nga data 1 qershor 2018 nuk mund ta bëjnë regjistrimin e automjeteve të tyre pa i paguar gjobat që mund t'i kenë për kundërvajtjet e shkaktuara në trafikun rrugor. Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", Ministria e Punëve të Brendshme thotë se kjo formë e pagesës së gjobave është në përputhshmëri me Ligjin për automjetet. "Neni 43, paragrafi 2 i Ligjit për automjete, thotë se pronari i mjetit nuk mund ta bëjë regjistrimin apo vazhdimin e regjistrimit të

mjetit me veprim motorik, as ndërrimin e pronarit, pa e bërë shlyerjen e gjobave për kundërvajtje në trafikun rrugor", thuhet në përgjigjen e kësaj ministrie. Kjo mënyrë, sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, do t'i shërbejë rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të pagesave të gjobave për veprat kundërvajtës në trafik si dhe do të ndikojnë në parandalimin dhe zvogëlimin e numrit aksidenteve në trafik. Ndërkohë, vetëm në pesë muajt e parë të këtij viti, Policia e Kosovës ka shqiptuar rreth 37 000 gjoba për kundërvajtje në trafik. "Policia e Kosovës gjatë kësaj periudhe,

për pesë muajt e parë të këtij viti, në gjithë territorin e Kosovës ka shqiptuar 36 617 tiketa për kundërvajtje në trafik, derisa për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar pati shqiptuar 33 556 tiketa. Shprehur në përqindje, këtë vit kemi një rritje prej 9.12 përqindësh", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", zëdhënësi i Policisë së Kosovës Bajram Krasniqi. Ndërkohë qytetarët e Kosovës kanë borxhe të mëdha edhe ndaj dy kompanive publike që ofrojnë shërbime për konsumatorët. Borxhi i përgjithshëm i konsumatorëve vetëm në Ujësjellësin Rajonal "Prishtina" që nga paslufta deri më tani është rreth 50 milionë euro. Zëdhënësjë e Ujësjellësit Rajonal "Prishtina", Arjeta Mjeku, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se për konsumatorët të cilët nuk paguajnë faturat janë duke bërë shkyçjet nga shërbimet e ujësjellësit. "Me shkyçje po përballet secili konsumator që ka dy apo më shumë fatura të papaguara ndaj shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit. Brenda katër muajve janë realizuar 700 shkyçje individuale, janë vizituar mbi 3500 konsumatorë borxhlinj dhe janë dërguar te

përmbauesit privatë rreth 1 200 lëndë të konsumatorëve që nuk janë të rregullt ndaj shërbimeve ndaj ujësjellësit", ka thënë Mjeku. Po ashtu, ajo ka bërë me dije se të gjithë konsumatorët që kanë përfituar nga Ligji për faljet e borxheve publike dhe nuk i janë përmbajtur kontratës për pagesën e kështit të borxhit të riprogramuar do t'i kthehet borxhi i falur. Derisa në kompaninë "Pastrimi", zëdhënësjë Arbnore Ademi ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" janë afër 20 milionë euro borxhe të qytetarëve. Fatura mujore, prej pesë eurosh për shërbimet që bën kompania "Pastrimi", sipas Ademit, është e ulët dhe se qytetarët do të duhet të tregohen më përgjegjës ndaj obligimeve që kanë për shërbimet që marrin. Forma e vetme që kjo kompani përdorë për t'i inkasuar borxhet e konsumatorëve është dërgimi i lëndës te përmbauesi privat. "Në vazhdimësi jemi duke dërguar lëndë te përmbauesi privat. Kemi filluar me qytetarët që kanë borxhe shumë të mëdha, pastaj duke vazhduar në bazë të radhitjes. Kemi qytetarë që nuk kanë pagur asnjëherë faturat që nga periudha e pasluftës deri më

tani. Kompania 'Pastrimi', jo si ndërmarrjet publike, nuk e ka formën e kushtëzimit ndaj qytetarëve, por dërgimin e lëndëve të konsumatorëve te përmbauesi privat", ka thënë Ademi. Përfaqësues të organizatave për të drejtat e njeriut në Kosovë thonë se qytetarët, nëse duan një shtet ligjor, duhet të jenë shembull i respektimit të ligjeve apo vendimeve dhe pagesave për shërbimet e marra. Behxhet Shala, drejtor ekzekutiv në Këshillin për Mbrojtjen Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Kosovë, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se mënyra më efikase e inkasimit apo pagesës së gjobave do të ishte krijimi i një departamenti të veçantë, i cili do ta bënte ekzekutimin e përshpejtuar të këtyre vendimeve. "Mënyrë më efikase është që në kuadër të Gjykatës Themelore të krijohet një departament i veçantë i cili do ta bënte ekzekutimin e përshpejtuar të vendimeve, qoftë të Policisë, qoftë të gjykatave, në mënyrë që të mos shkojë rasti te përmbauesi privat, pasi që përmbauesit me veprimet e tyre shumë shpesh e rrezikojnë ekzistencën e qytetarit", ka thënë Shala.

Të hyrat buxhetore arrijnë vlerën 362 milionë euro

Sipas raportit të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), në tremujorin e parë të këtij viti të hyrat buxhetore kapën shifrën 362 milionë euro apo 6.7 për qind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Po ashtu, krahas rritjes së të hyrave buxhetore, rritje ka shënuar edhe borxhi i brendshëm në 1 miliard euro që është për 9.1 për qind më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar

siderueshme gjatë TM1 2018", është thënë në raportin e BQK-së.

Sipas këtij raporti, të hyrat indirekte arritën vlerën prej 261.5 milionë eurosh (3.5 për qind rritje). "Të hyrat jotatimore, që kryesisht janë të hyra nga organizatat buxhetore, shënuan rënie prej 8.3 përqindësh dhe arritën vlerën 41.1 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore arritën vlerën prej 400.7 milionë eurosh, që paraqet një rritje vjetore prej 20.2 përqindësh. Gjatë kësaj periudhe të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore u karakterizuan me rritje. Shpenzimet qeveritare për paga shënuan rritje prej 5.1 përqindësh dhe arritën vlerën prej 143.6 milionë eurosh", është theksuar në raportin e BQK-së, ndërsa subvencionet dhe transferimet shënuan rritje për 17.7 për qind dhe arritën vlerën prej 127.3 milionë eurosh. "Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe komunalitë) shënuan rritje për 20.2 për qind

dhe arritën vlerën prej 48.9 milionë eurosh. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 20.2 për qind të gjithëj shpenzimeve buxhetore, shënuan rritje prej 44 përqindësh dhe arritën vlerën 80.9 milionë euro. Duke pasur parasysh rritjen më të lartë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 38.6 milionë eurosh (5.9 milionë euro suficit në TM1 2017)", është thënë në raportin e BQK-së.

Ndërkaq sa i përket borxhit publik (TM1 2018) ka arritur në 1 miliard euro që është për 9.1 për qind më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja e borxhit publik në Kosovë i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 27.8 përqindësh, i cili ka arritur në 612.5 milionë euro. Sipas këtij raporti, borxhi i jashtëm publik ka shënuar rënie prej 10.2 përqindësh duke arritur në 416 milionë euro. "Pra, pjesa më e madhe e borxhit publik (59.6 për qind) është borxh i brend-

shëm, që kryesisht përbëhet nga borxhi i Qeverisë së Kosovës ndaj bankave komerciale (43 për qind), institucioneve publike (33 për qind), fondeve pensionale (20 për qind) etj. Pjesa tjetër e borxhit publik (40.4 për qind) është borxh i jashtëm, që kryesisht i përket Fondit Monetar Ndërkombëtar me 38 për qind, Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim me 37 për qind, Agjencisë Gjermane për Rindërtim me 13 për qind etj", është bërë me dije në raportin e BQK-së, duke u shtuar se si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.2 për qind nga 15 për qind sa ishte në TM1 2017. "Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit është ende larg pragut prej 40 përqindësh të paraparë me ligj. Për më tepër, ky nivel i borxhit publik e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit, të cilat, sipas FMN-së, kanë një mesatare të borxhit publik prej 59.1 përqindësh", theksohet në raportin e BQK-së.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Sipas raportit të vlerësimit të tremujorit të parë (TM1) për zhvillimet makroekonomike të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), gjatë këtij tremujori sektori fiskal u karakterizua me performancë të mirë të të hyrave buxhetore dhe rritje të shpenzimeve buxhetore.

Sipas këtij raporti, të hyrat buxhetore arritën vlerën prej 362 milionë eurosh apo 6.7 për qind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. "Rritja e arkëtimit të të

hyrave buxhetore erdhi si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik, por edhe reformave të ndërmarra nga agjencitë e të hyrave që kanë për synim ngushtimin e hendekut tatimor. Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arkëtohen nga tatimi në të ardhura dhe pasuri. Këto të hyra në TM1 2018 shënuan rritje prej 26.5 përqindësh dhe arritën vlerën prej 72.5 milionë eurosh. Me rritje u karakterizuan edhe të hyrat tatimore indirekte të cilat janë të ndërlidhura me lëvizjen e importit, i cili ka shënuar rritje të kon-



Ministri i ri i Ekonomisë zotohet se Italia do të qëndrojë në euro

ROMË, 10 QERSHOR - Qeveria italiane nuk ka qëllim të largohet nga euro dhe planifikon të fokusohet në shkurtimin e niveleve të borxhit dhe

dëshiron ta rrisë rritjen ekonomike përmes investimeve dhe reformave. Kështu ka thënë ministri i ri i Ekonomisë, Giovanni Tria. Ai i ka thënë gazetës

"Corriere della Sera" se ka për qëllim shkurtimin e borxhit të Italisë. "Qëllimi ynë është ta forcojmë rritjen ekonomike dhe të hapim vende të

reja të punës", ka thënë ai, duke shtuar se në muajin shtator ai do t'i paraqesë parashikimet ekonomike para kabinetit qeverisës.

Bordi i NPB-së i bën thirrje Shpend Ahmetit të reflektojë

PRISHTINË, 10 QERSHOR (ER) - Bordi i Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB) i ka bërë thirrje kryetarit të Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, t'i ndalë sulmet joetike dhe joligjore ndaj kësaj ndërmarrje dhe t'i kthehet ligjshmërisë. "Kërkojmë nga kryetari Ahmeti t'i kompletojë organet qeverisëse të cilat janë kompetencë e tij dhe e Kuvendit Komunal për të vazhduar më tutje procedurat e rregullta të përzgjedhjes së Bordit të ri", është thënë në komunikatën e NPB-së.

Më tej theksohet se bordi ekzistues i Ndërmarrjes Publike Banesore është legjitim dhe po vepron sipas nenit 171, pika 3 e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, ku thuhet se, pavarësisht prej skadimit të afatit të Bordit të Drejtorëve, ai vazhdon ushtrimin e detyrave të tij përdorisë të zgjedhet pasardhësi në mënyrë



që veprimtaria e Bordit të veprorë pa pengesë, sikurse edhe në të kaluarën është i gatshëm për bashkëpunim. "NPB-ja është përkrahëse e planeve zhvillimore për NPB-në dhe qytetarëve, por do të jetë gjithmonë kundër politikave denigruese dhe në kundërshtim me ligjin të cilat bëhen për përfitimin e një pakice. Ndërmarrja Publike Banesore mbetet e hapur dhe transparente për bashkëpunim me të gjitha institucionet për vendosjen e ligjit në vend", është theksuar në komunikatën Ndërmarrjes Publike Banesore.



Kryeparlamentari Veseli nderon Mic Sokolin

FERIZAJ, 10 QERSHOR (ER) - Në kuadër të shënimit të 40-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në Slivovë të Ferizajt ka bërë

homazhe pranë varrit të njërit prej drejtuesve kryesor të Lidhjes dhe komandantit të njohur të njërive luftarake të saj, Mic Sokoli. "Shenjat e sakrificave tona për liri janë në

çdo cep të Kosovës. Do t'i kujtojmë e nderojmë gjithmonë, si pjesë të pandashme të identitetit tonë historik e shtetëror", ka theksuar me këtë rast kryeparlamentari Veseli.

Ali Berisha rikthehet në krye të AAK-së në Pejë

PEJË, 10 QERSHOR (ER) - Ali Berisha është rikthyer kryetar i Degës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Pejë. Berisha me të marrë detyrën e kryetarit të degës së AAK-së në Pejë ka theksuar se do të punojë 24 orë për t'ia rikthyer fitoren kësaj partie në Pejë. "Dyert e partisë janë të hapura për të gjithë", ka thënë Ali Berisha. Ai ka shtuar se opozitarizimi i AAK-së në këtë qytet do të jetë konstruktiv dhe do të karakterizohet në heqjen e maskës ndaj pushtetit aktual komunal. "Është nder i veçantë për mua, të marrë këtë detyrë nga Fatmir Gashi, një model politikani e ekonomisti, një njeri i respektuar në punë, rast të cilin e humbëm bashkë më 22 tetor të vitit të shkuar, për ta vënë në krye të Komunës së Pejës. Me Fatmirin do të vazhdojmë së punuari bashkë. Detyra që kam



marrë sot për mua është një rikthim në degën e Pejës, por së

pari një përgjegjësi", ka thënë Berisha.

Në Gjimnazin 'Bedri Pejani' do të investohen rreth 200 mijë euro

PEJË, 10 QERSHOR - Drejtori i Arsimit në Komunën e Pejës, Besim Avdimetaj, ka bërë me dije se në Gjimnazin "Bedri Pejani" gjatë ditës së shtunë kanë filluar punimet e para për rinovimin e tërësishëm të objektit shkollor. Ai për gazetën lokale "Zarfi Info" ka thënë se ky investim kap koston rreth 200 mijë euro nga buxheti i përbashkët ndërmjet MASHT-it dhe Komunës së Pejës.

Avdimetaj ka treguar se nga këto mjete është planifikuar meremetimi i tërësishëm i klasave, shtrimi i dyshemeve, korridoreve, dyerve dhe hapësirave të tjera të kësaj shkolle. "Nga terreni kemi parë se deri më tani gjithçka po shkon ashtu si është planifikuar", ka thënë Avdimetaj. Ai ka shtuar se investimet e tilla s'ka dyshim se ndikojnë pozitivisht në përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë së arsimit. "S'ka dyshim se investimet e tilla ndikojnë pozitivisht në ngritjen e nivelit dhe cilësisë së arsimit. Andaj ne si drejtori, në bashkëpunim me MASHT-in dhe kryetarin e komunës, z. Gazmend Muhaxheri, po mundohemi të kontribuojmë për rregullimin dhe ofrimin e kushteve sa më të mira për nxënësit e shkollave të Pejës,



sepse kur ambienti dhe kushtet e mira për mësim nuk mungojnë, atëherë nuk do të mungojë as vullneti i nxënësve për mësimnxënie", ka thënë Avdimetaj, duke bërë me dije se deri në fillimin e vitit të ri shkollor punimet do të përfundojnë dhe se Gjimnazi "Bedri Pejani" do të jetë i gatshëm për pranimin e nxënësve të rinj.

Aksident me fatalitet, vdesin tre persona në rrugën Pejë - Vitomiricë

PEJË, 10 QERSHOR (ER) - Një aksident trafiku me fatalitet ka ndodhur të dielën në rrugën Pejë - Vitomiricë, konkretisht në lagjen "Fidanishtë", ku kanë mbetur të vdekur tre persona dhe një tjetër ka marrë lëndime

trupore. Lidhur me aksidentin është njoftuar prokurori i shtetit, i cili ka marrë pjesë në vendin e ngjarjes dhe me urdhrin e tij trupat e viktimave u janë lejuar familjarëve për ceremoni mortore.



Deputetët duhet të dinë çfarë përfiton Kosova nga ndërtimi i Termocentralit të Ri



Gazmend ABRASHI

Kosova ka nevoja të mëdha për investime të huaja, të cilat sjellin hapje të vendeve të punës dhe zhvillim ekonomik. Një prej projekteve më të mëdha në vend është projekti për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re", një projekt që siguron energji për vendin, po ashtu edhe hap vende të reja pune për të cilat Kosova ka nevoja të mëdha. Nga paslufta e deri më tani investimi më i madh në Kosovë vazhdon të mbetet IPKO, e cila ishte futur në vitin 2007 në tregun e Kosovës.

Vlera e investimeve në Termocentralin "Kosova e Re" prej 1 miliard e 300 milionë eurosh më bën të mendoj dhe të jem i bindur se realizimi i tij të vazhdojë fuqishëm. Si pjesë e Qeverisë, por edhe si individ vlerësoj se ndërtimi i Termocentralit "Kosova e Re", me kapacitet prej 500 megavatesh orë energji elektrike, nuk duhet të ndalet për faktin se si shtet, por edhe si popull kemi humbur miliona euro, duke paguar për import të energjisë elektrike.

Projekti, por edhe kontrata për Kosovën e Re, janë transparente, madje Qeveria Haradinaj është qeveria e parë në vend që ka publikuar një kontratë kaq të

madhe, që nuk ka ndodhur edhe me projektet e autostradave një gjë e tillë.

Interpelanca e Partisë Socialdemokrate (PSD), në Kuvendin e Kosovës rreth marrëveshjes me "Contour Global", ka nxjerrë pasaktësi në Kuvend, pasi përmes kësaj interpelance kanë thënë se rryma do të shtrenjtohet për 60 për qind me "Kosovën e Re", derisa kostoja e termocentralit do të shkojë në 4.5 miliardë euro, diçka jo e kapshme dhe e pamundshme të ndodhë kjo.

Edhe sipas parimeve ekonomike dihet se investimi në pajisje, makineri dhe kudo tjetër vetvetiu sjellë rritje të çmimeve, por ato çmime nuk mund të jenë shumë të mëdha, edhe te rryma do të ketë shtrenjtim, por jo aq sa kanë thënë në PSD, por ato mund të shkojnë në rreth 30 për qind.

Po ashtu, PSD-ja dhe të gjithë duhet ta dinë se brenda një viti bizneset në vendin tonë humbin nga mosfurnizimi i rregullt me energji elektrike 300 milionë euro, madje furnizimi me rrymë edhe sipas raporteve të Odës Ekonomike të Kosovës, renditet si problemi më kryesor që ballafaqohen bizneset.

Nëse Qeveria e Republikës së Kosovës do ta prishte kontratën dhe do të tërhiqej nga projekti për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re" me "Contour Global" atëherë shteti i Kosovës do të duhet t'i paguajë në formë të ndëshkimit kësaj kompanie 19.2 milionë euro.

E mirë e Termocentralit "Kosova e Re" është sepse jetëgjatësia e tij do të jetë 40 vjet dhe pas një periudhe 20-

vjeçare, termocentrali do të jetë pronë e Qeverisë së Kosovës, pra do të thotë se 20 vjet do të operojë me të kompania "Contour Global" dhe 20 vjet të tjera do të jetë Qeveria e Kosovës.

Ndërtimi dhe punësimi

Se Kosova e Re është projekt serioz dhe premtues tregon edhe fakti se në ndërtimin e tij pritet të përfshihen kompani me shtirje globale siç janë: General Electric, Mitsubishi Hitachi, Siemens, Doosan etj., nëpërmjet një procesi ndërkombëtar të prokurimit për t'i përzgjedhur kompanitë të cilat do ta ndërtojnë impiantin e Termocentralit "Kosova e Re".

Me ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re", përveçse do të kemi furnizim stabil dhe cilësor me energji elektrike, do të kemi si vend edhe përfitime të mëdha, si në punësim, por edhe të banorëve në vendin ku do të ndërtohet termocentrali. Gjatë katër ose pesë vjetëve sa do të zgjasë ndërtimi i termocentralit të ri do të punësohen deri në 10 mijë persona, ndërkaq pas fillimit të prodhimit të energjisë elektrike në gjeneratorët e "Kosovës së Re" do të punësohen 500 persona, të cilët do të gëzojnë punësime të përhershme. Punësimet e tilla dhe stabile qoftë për një periudhë apo në mënyrë të përhershme do të jenë me efekte të mëdha dhe me ndikime të shumanshme në ekonomi.

Po ashtu, duhet të vlerësohet lart se si Qeveria e Kosovës kemi

arritur pajtueshmëri me kompaninë "Contour Global", që të krijohet Fondi për Zhvillimin e Komunitetit, buxheti i të cilit do ta arrijë shumën prej 10 milionë eurove, e që do të investohen për një periudhë shtatëvjeçare në të mirë të banoreve të zonës në projekte të ndryshme, qoftë infrastruktururore, por edhe të projekteve të tjera të cilat kanë rëndësi të madhe për aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive.

Termocentralet e vjetra

Se kontrata me kompaninë "Contour Global" për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re" duhet të bëhet dhe mos të ndalet tregon edhe vjetërsia e termocentraleve ekzistuese të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), që janë ndërtuar pas viteve të '60-ta dhe '70-ta. Si pasojë e vjetërsisë së tyre dhe prishjeve të shpeshta buxheti i shtetit ka humbur miliona euro nga mungesa e prodhimit në to. Sipas statistikave, vetëm nga buxheti vetjak i KEK-ut, pas vitit 2013, kur është bërë privatizimi i rrjetit të shpërndarjes dhe furnizimit, tash KEDS, janë investuar 76 milionë euro vetëm për riparime në dy Termocentralet "Kosova A" me pesë blloqe, është ndërtuar më 1962 dhe "Kosova B" me dy blloqe, që është ndërtuar më 1975, po ashtu nuk duhen harruar edhe investimet në periudhën 2003-2016, që kapin shumën më shumë se 400 milionë euro në blloqet e këtyre dy termocentraleve. Një statistikë e frikshme është

edhe ajo për import të energjisë elektrike, ku nga viti 2000 deri më 2015 janë shpenzuar rreth 540 milionë euro. Në total, sipas statistikave, që nga pas lufta investimet në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë arrijnë në mbi 1.2 miliard euro. Duke llogaritur këtë shumë dhe humbjet e bizneseve nga mungesa e rrymës, me një vizion të qartë do të mund ta ndërtonim deri më tani edhe vetë Termocentralin "Kosova e Re" dhe tash ne do t'i kishim kilovatët e parë të rrymës nga blloqet e reja gjeneruese.

Si vend, Republika e Kosovës, ka më shumë se 10 miliardë tonelata linjit dhe si të tillë jemi vendi i pestë në botë për nga sasia e qymyrit dhe mosshfrytëzimi i kësaj pasurie natyrore do të ishte gabim fatal me dëme të mëdha.

Kosova nuk ka burime të mjaftueshme hidrike për të prodhuar rrymë nga uji, e as nuk kemi mundësi për të prodhuar energji elektrike nga era për shkak të konfiguracioneve geografike të terrenit.

Duhet ta kuptojmë të gjithë se me blloqet e stërvjetruara në termocentralet ekzistuese nuk mund të kemi stabilitet të furnizimit me energji elektrike. Për këtë dhe fakte të tjera që i përmenda më lart duhet të kemi kapacitete të reja gjeneruese, pavarësisht kostove ndërtuese, sepse kostoja më e lartë është ajo e rrymës nga importi sesa të kemi termocentral të ri.

(Autori është koordinator nacional për Ballkanin Perëndimor dhe Këshillin për Bashkëpunim Rajonal - KBR)

Haxhiu reagon për ndalimin e qytetarëve në kufi për shkak të gjobave

PRISHTINË, 10 QERSHOR (ER) - Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka reaguar ndaj ndalimit të qytetarëve që po u bëhet në kufi për shkak të gjobave që kanë në komunikacion. Përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook", ajo ka thënë se gjobat të cilat shqiptohen në komunikacion duhet të paguhen por, sipas saj, kjo formë, përveçse është maltretim për qytetarët, është edhe e paligjshme dhe jokushtetuese dhe duhet të ndalohet sa më parë. "Kjo formë, pa vendim/urdhër gjykatë, pa njoftim paraprak, pa ftesë, pra pa zbatim ligji,

është kidnapim. Qeveria e pakicës, por megalomane me poste ministrore e zëvendës, pa problem i falë 53 milionë euro 'Bechtel Enka'-s, paguan borxhet e serbëve me taksat tona, i ngrit pagat për vete, rehaton militantët nëpër institucione/ndërmarrje, shpik poste për t'i kënaqur apetitet e individëve e grupeve, rrezikon gjigantët ekonomikë, ndaj qytetarëve po qëndron me kamxhik!", ka deklaruar ajo. Haxhiu ka thënë se këto vendime duhet të ndalohen sa më parë, duke i quajtur absurde dhe të paligjshme dhe që po ua vështirësojnë edhe më shumë jetën qytetarëve.



Macroni: Diplomacia nuk bëhet me kriza inati

PARIS, 10 QERSHOR - Diplomacia nuk mund të diktohet nga "krizat e inatit", tha presidenti francez Emmanuel Macron, pasi samiti i G7-s në Kanada përfundoi me Donald Trumpin që nuk firmosi deklaratën e përbashkët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

tregtare. Në "Twitter", presidenti amerikan e cilësoi mikpritësin kanadez Justin Trudeau si "të pandershëm dhe të dobët". Zyra e Macronit tha se Franca dhe vendet e tjera të Bashkimit Evropian do ta mbështesin komunikatën përfundimtare

të G7-s. "Le të jemi seriozë dhe të denjë për popullin tonë. Ne ndërmarrim angazhime dhe u përmbahemi atyre. Bashkëpunimi ndërkombëtar nuk mund të diktohet nga ndjenjat e zemërimit dhe inatit", lexohet në deklaratën e Presidencës franceze.

Presidenti amerikan Donald Trump ka tërhequr firmën e tij nga deklaratat e përbashkëta të lëshuara në fundin e samitit të G7-s, duke akuzuar Kanadanë për pandershmëri. Sipas tij, vendet e tjera po vendosnin tarifa masive ndaj Shteteve të Bashkuara.



Trumpi dhe Kim Jongu arrijnë në Singapor, pritjet ta mbajnë takimin historik

Dy udhëheqësit kanë pasur një marrëdhënie të jashtëzakonshme me ulje-ngritjet e veta gjatë 18 muajve të fundit, duke këmbyer ofendime e duke kërcënuar për luftë, përpara se të ndryshonin gjithçka në mënyrë drastike, për ta ndjekur kursin drejt një takimi kokë me kokë



quajti atë "të çmendur dhe të vonuar". E, pavarësisht prej fushatës me presion maksimal nga Shtëpia e Bardhë, Koreja e Veriut mbeti e palëkundur dhe zhvilloi edhe testin e gjashtë bërthamor në shtator të vitit 2017. Vetëm pak pas tij, Kim Jongu deklaroi se vendi i tij kishte përbushur misionin

për t'u bërë një shtet me fuqi bërthamore e me raketa që do të mund të arrinin deri në Shtetet e Bashkuara. Por, në fillim të këtij viti Koreja e Veriut nisi përpjekjet për t'i sheshuar kontradiktat me Korenë e Jugut gjatë Lojërave Olimpikë Dimërore në Pyeongyang. Në mars, Trumpi

surprizoi botën kur pranoi ftesën e Kimit, dhënë përmes Seulit, për t'u takuar personalisht me të.

Që prej atëherë udhërrëfyesei drejt samitit ka pasur pengesa dhe paqartësi, teksa Trumpi fillimisht e anuloi takimin e më pas pranuan sërish të uleshin me njëri-tjetrin.

Shtetet e Bashkuara kërkojnë nga Koreja e Veriut të heqë dorë nga armët bërthamore në mënyrë të pakthyeshme, me certifikimin e ndërkombëtarëve. Vetëm kur të tilla hapa të ndërmerreshin, atëherë sanksionet e Kombeve të Bashkuara do të nisnin të lehtësoheshin, siç paralajmëroi së fundi edhe sekretari amerikan i Mbrojtjes, James Mattis. Por, kjo nuk do të thotë se ShBA-ja pret nënshkrimin e paktit përfundimtar në Singapor. Presidenti Trump e ka përshkruar samitin si një proces njohjeje të situatës, ndaj do të duhet më shumë kohë. Ndërkohë, Kim Jongu është shprehur se tashmë dëshiron të fokusohet te forcimi i ekonomisë koreane-veriore e përmes saj kërkon edhe lehtësimin e sanksioneve ndërkombëtare.

WASHINGTON, 10 QERSHOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump dhe udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong, kanë mbërritur në Singapor për samitin e parashkuar mes tyre që pritjet të mbahet nesër (e martë).

Takimi historik mes dy udhëheqësve do të zhvillohet në ishullin turistik të Sentosës të martën. Kjo do të jetë hera e parë që kreu i Koresë komuniste do të takohet me një president amerikan në detyrë. Përpara nisjes, Trumpi e përshkroi samitin si një "mundësi e artë e vetme" për paqen, teksa tha se të dy ata do të jenë "në një territor të panjohur" në kuptimin e plotë të fjalës. Presidenti amerikan pritjet të mbërrijë më vonë gjatë kësaj të diele.

Uashingtoni shpreson që samiti të jetë pikënisja e një procesi që do të detyrojë Kim Jongunin të

heqë dorë nga armët bërthamore. Dy udhëheqësit kanë pasur një marrëdhënie të jashtëzakonshme me ulje-ngritjet e veta gjatë 18 muajve të fundit, duke këmbyer ofendime e duke kërcënuar për luftë, përpara se të ndryshonin gjithçka në mënyrë drastike, për ta ndjekur kursin drejt një takimi kokë me kokë. Dy udhëheqësit do të takohen me kryeministrin e Singaporit, Lee Hsien Loong, përpara samitit mes tyre. Viti i parë i Trumpit në detyrë është shënuar nga deklarata të ashpra kundrejt Kim Jongunit dhe Koresë së Veriut, me këtë të fundit që zhvilloi disa teste raketash balistike në sfidim të hapur me paralajmërimet ndërkombëtare. Presidenti amerikan u zotua t'i përgjigjej me "zjarr e furi" nëse Peniani do të vijonte t'i kërcënonte Shtetet e Bashkuara. Në kundërpërgjigje, Kim Jongu e

Putini, i gatshëm të takohet me Trumpin



PEKIN, 10 QERSHOR - Presidenti rus Vladimir Putini tha se është i lumtur të takohet me presidentin e Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, kur Uashingtoni të jetë i gatshëm të mbajë një takim të tillë. Ai tha se mirëpret thirrjen e Trumpit që Moska të rikthehet në samitet e shtatë vendeve më të industrializuara (G7).

Duke folur para gazetarëve në Qingdao të Kinës, Putini tha se ai me Trumpin duhet të mbajnë një samit. "Presidenti amerikan në vazhdimësi ka thënë se është e arsyeshme që të mbajmë një takim të tillë. Kurdo që ShBA-ja të jetë e gatshme, takimi do të ndodhë", tha Putini. Putini dhe Trumpi kishin biseduar përmes telefonit në muajin

mars, ku ishte diskutuar për një takim të mundshëm në mes të dy liderëve, por edhe dy liderët kishin shprehur shqetësime me garën e armëve. "Mund të konfirmoj se presidenti Trump ka shprehur shqetësim lidhur me raundin e ri të garës së armëve gjatë bisedës sonë të fundit. Unë pajtohem plotësisht me të", tha Putini.

Irani i bën thirrje Evropës ta shpëtojë paktin bërthamor

PEKIN, 10 QERSHOR - Irani ka paralajmëruar Evropën se koha po mbaron për të shpëtuar marrëveshjen bërthamore që ka arritur me fuqitë botërore dhe ka kritikuar Shtetet e Bashkuara për "unilaterizëm" me tërheqjen nga pakti. Presidenti iranian Hassan Rohani gjatë samitit të Organizatës për

Bashkëpunim që po mbahet në Kinë tha se përpjekjet e ShBA-së për "t'i imponuar politikën e saj mbi të tjerët janë rritur dhe paraqet kërcënim për të gjithë". "Shembulli i fundit i unilateralizmit ishte tërheqja e Qeverisë amerikane nga marrëveshja bërthamore", tha Rohani. Komentet e Rohanit në Kinë vijonë

vetëm një ditë pasi kryeparlamentari iranian Ali Larijani tha se është koha që Evropa të dëshmojë se mund ta shpëtojë marrëveshjen. Më 2015, Irani arriti marrëveshje me fuqitë botërore. Marrëveshja i mundëson Iranit lehtësim të sanksioneve në këmbim të frenimit të programit bërthamor.



TALAT XHAFERI MBAN FJALIM NË PRIZEREN



ISMET SYLEJMANI

Lidhja Shqiptare e Prizerenit është ngjarja madhore e popullit shqiptar dhe e luftës për liri e çlirim të Atdheut!

Që kur është mbajtur më 10 qershor 1878 e gjithmonë nëpër histori, Lidhja ka qene frymëzuesja më e madhe e çdo atdhetari, politikani e luftëtari patriot kombëtar shqiptar!

Programi politiko-patriotik, luftarak e çlirimtar i lidhjes ka qenë pjesë e çdo organizimi të mirëfillt që pas shuarjes se saj me gjak e dhunë nga perandoria turke!

Abdyl Frasheri e Ymer Prizereni, Sylejman Vokshi e Mic Sokoli, por edhe qindra emra të mëdhenj e figura të lavdishme udhëheqës, drejtues e pjesmarës të Lidhjes Shqiptare të Prizerenit, sot shikojnë e dëgjojnë nga qielli e nga amëshimi i botës tjetër, se si vëllezërit e

bijtë e Tyre janë mbledhur në Prizeren, kur dikur Ata u lidhën me besa-besë, për të çliruar tokat shqiptare nga perandoria pushtuese turke!

Kompleksi i famshëm memorial e historik i Lidhjes Shqiptare të Prizerenit, në përvjetorin e 140, ka pritur një pjesmarrës të veçantë, i cili me pjesmarrjen e Tij shënon një ngjarje të madhe kombëtare, shënon nderim maksimal të luftës titanike çlirimtare, që ka zhvilluar populli shqiptar, që pas shuarjes me gjak të Lidhjes!

Në 140 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizerenit, ka marrë pjesë dhe ka mbajtur fjalim, kryetari shqiptar i parlamentit të Maqedonisë, komandant brigade i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, shqiptari në zë e politikani i shquar Talat Xhaferi!

Edhe atdhetari më i madh shqiptar e më optimist nuk ka mundur të shpresojë e të besojë, se në përvjetorin e 140-të të Lidhjes Shqiptare të Prizerenit, jo vetëm do të jemi të lirë e të pavarur nga Serbia pushtuese, por në këtë përvjetor jubilar vjen dhe rreshtohet të bëjë nderim dhe të mbajë fjalimin e parë historik, shqiptari i parë që udhëheq me parlamentin e

Maqedonisë, ushtaraku i karrieres e komandant brigade i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare Talat Xhaferi!

Flamuri i Lidhjes Shqiptare të Prizerenit, në shtetin e Maqedonisë ku është kryetar i parlamentit Talat Xhaferi, pas përfundimit me fitore të luftës së popullit shqiptar në Maqedoni dhe të ushtrisë së tij UÇK-së, me vendim shteti dhe me ligj i garantuar, është i lirë të përdoret dhe të valëvitet kudo në ish Republikën jugosllave të Maqedonisë!

Gjuha e Lidhjes Shqiptare të Prizerenit ishte gjuha shqipe, kjo gjuhë është zyrtare edhe në Maqedoni, ku është kryetar i parlamentit, kryetari Talat Xhaferi!

Me paraqitjen në përvjetorin e 140 të kryetarit Talat Xhaferi, dëshmohet shumanshëm, se themeluesit e UÇK-së, heronjtë dhe dëshmorët e kombit, luftëtarët e lavdishëm të çlirimtarit të Kosovës nga Serbia pushtuese, e kanë projektuar dhe realizuar me sukses ecjen e lavdishme për lirinë dhe çlirimin e tokave të pushtuara të Atdheut!


Gramoz Ruçi, Kadri Veseli e Talat Xhaferi, tre shqiptar kryetare parlamentesh, kjo

është fitore, kjo është historike, kësaj i thonë madhështi kombëtare!

Programi i lidhjes së famshme shqiptare të Prizerenit është realizuar në masë të madhe në Maqedoni e do të zbatohet gjithnjë e më shumë edhe në të ardhmen!

Populli shqiptar në përgjithësi dhe ai në Maqedoni në veçanti, do të jenë në vazhdimësi në ndikimet progresive të programit politiko-patriotik të Lidhjes Shqiptare të Prizerenit!

Prishtinë, 10 qershor 2018!



E jashtëzakonshme

Aeroporti "fantazmë"

Në aeroportin ndërkombëtar të Nikosias avionët nuk fluturojnë që prej më shumë se 40 vjetëve. Ky aeroport nuk përdoret që prej vitit 1974, kur një grushtshteti nga ushtria në Greqi rriti valën e nacionalizmit në Qipro, duke nxitur kështu edhe ndërhyrjen ushtarake të Turqisë në ishull. Që prej asaj kohe aeroporti është braktisur, ndërsa të vetmit vizitorë janë zogjtë të cilët e kanë mbuluar



zonën me glasa. Ky aeroport tashmë ka fituar statusin e "aeroportit fantazmë".

BARSOLETA E DITËS



Polici: Pse nuk na keni lajmëruar më herët se ju është grabitur shpija, por kaq vonë? Genti: Po mendova se motra ime është duke u bërë gati të dalë në qytet se, sa herë që del, kështu lëmsh e bën.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 15:00

"AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



FOTO E DITES



"Vullkan i zjarrit" në Escuintla, Guatemala. Fotografi e realizuar nga AP.

Në ora 18:00

"ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

"DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesey, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do të shfaqet në ora 13:00 dhe 20:00.




E rrallë

ShBA-ja ia rikthen Spanjës letrën e vjedhur të Kristofor Kolombos

ShBA-ja ia ka kthyer Spanjës një letër të vjedhur 500-vjeçare të Kristofor Kolombos, pas një hetimi shtatëvjeçar. E shkruar në vitin 1493, letra për-



shkruan zbulimet e eksploruesit në Botën e Re dhe iu dërgua mbretit Ferdinand dhe Mbretëresha Isabella të Spanjës.



Në ora 22:00

"I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI

Nëse doni të ndryshoni diçka tek


vetja apo në jetën tuaj, sot është dita ideale. Çdo gjë mund të fillojë të funksionojë ndryshe që sot.



DEMI

Sot po humbisni bastin me veten.

Kishit menduar që do të përfundonit më herët një projekt të caktuar, por nuk keni arritur as në gjysmë të rrugës.



BINJAKËT

Në këtë moment të jetës suaj mund

të zgjidhni një mundësi që do t'ju përfshijë në të gjitha senset edhe profesionalisht edhe personalisht.



GAFORRJA

Nuk ka mënyra specifike për t'ju

pëlqyer njerëzve të ndryshëm. Nëse jeni interesant apo jo për të tjerët, nuk duhet t'ju shqetësojë kaq shumë.



LUANI

Gjithmonë ka qenë instikti që ju ka

udhëhequr. Për këtë arsye nuk keni pse planifikoni deri në detaje një situatë të caktuar sepse çdo gjë do të ndryshojë.



VI RGJËR ESHA

Përpara se t'i përgjigjeni në

mënyrë të pasjellshme dikujt bëni mirë të reflektoni. Mund të ndryshojnë pozicionet tuaja në të ardhmen.



PESHORJA

Nëse doni të bisedoni me dikë

kërkojini një takim. Nuk mund ta marrë me mend nga të tjerët atë që ju intereson juve.



AKREPI

Ka gjëra që mund të përmirësoni gjatë ditës

suaj, por për këtë ju nevojitet pak kohë në dispozicion. Bëni mirë t'i dëgjoni këshillat e një miku.



SHIGJETARI

Familja po ju mban peng të një

kujtimi të shkuar, por duhet të bëni zgjedhjet tuaja dhe ta ndiqni momentin pa kthyer kokën pas.



BRICJAPI

Edhe pse nuk jeni në kushte të mira

fizike sot, do të keni mjaft punë dhe impenjime të cilat duhet t'i zgjidhni patjetër brenda ditës.



UJORI

Nuk doni të flisni me

eporët për mangësitë e bashkëpunëtorëve tuaj, por në këtë rast do t'i hapni shumë telashe vetes.



PESHQIT

Keni zgjedhur mënyrën

më të mirë për ta kaluar ditën. Duke larguar nga vetja çdo lloj forme stresi apo tensioni që mund t'ju lëndojë.

Çmimin 'Mujë Krasniqi' e fitoi Ansambli i Këngëve dhe Valleve 'Shotë Galica' e Drenasit



Enver MALOKU

KLINË, 10 QERSHOR - Ka përfunduar në Klinë Festivali Folklorik Mbarëkombëtar "I këndojmë lirisë", i cili është mbajtur më 6, 7 dhe 8 qershor. Çmimin kryesor "Mujë Krasniqi", të edicionit të 18 të këtij festivali, e ka fituar me plot meritë Ansambli i Këngëve dhe i Valleve "Shotë Galica" nga Drenasi. Këtij ansambli çmimin ia dorëzuan Rifat Jashari nga familja Jasharaj dhe Halil Krasniqi, babai i komandant Mujë Krasniqit. Shaqir Hasi, udhëheqës i këtij ansambli, thotë se është i kënaqur dhe ndihet krenar që e kanë fituar çmimin "Mujë Krasniqi". "Diçka të veçantë kemi sjellë në këtë festival, duke bërë përpunim të këngëve të teksteve për Mujë Krasniqin të marra nga baladat kushtuar komandant 'Kapuçit' që janë të papërsëritura deri më tash. Vetëm kënga 'Herët në mëngjes' është e papër-

punuar", është shprehur Hasi. Ndërkaq, vendin e dytë juria profesionale ia ka dhënë AKV-së "Dëshmorët e Kombit" nga Kastrioti, të cilin çmimin ia dorëzuan kryetari Komunës së Klinës, Zenun Elezaj dhe nënkryetari Besim Hoti. Çmimin e tretë e ka marrë Ansambli Polifonik "Longjeria" nga Gjirokastra. Çmimin e publikut Shoqëria Kulturore Artistike "Malsori" e Gjonajt të Hasit. Juria profesionale ishte në përbërje të Minire Fetahut, redaktore e muzikës në RTK; Burim Krasniqit, kompozitor-producent; Mehmet Xhemajli, Ma. i lëndës muzikore të harmonisë dhe Gjon Frroku, kantautor. Nga 15 çmime sa ndahen në këtë festival, juria ndau edhe çmimin e veteranit të festivalit, grupit më të kompletuar, interpretuesit të valles më të mirë, valltarit e ansamblit më të kompletuar, si dhe çmime të tjera. Festivali i sivjetmë ka zgjuar

interesim të jashtëzakonshëm si asnjëherë më parë. E vogël ishte hapësira për t'i zënë të gjithë që kishin ardhur për ta përcjellë festivalin, ndaj edhe rrugët përballë hapësirës ku mbahej festivali ishin të mbushura me spektatorë. Festivalin Folklorik "I këndojmë lirisë" e kanë moderuar me mjaft sukses Shqipe Desku dhe Faik Gashi. Kryetari Komunës së Klinës, prof. dr. Zenuna Elezaj, i ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit në festival duke u dëshiruar pjesëmarrje të serishme edhe në festivalet e ardhshme. "Ne si komunë e kemi mbështetur Festivalin Folklorik Mbarëkombëtar 'I këndojmë lirisë' duke bërë të mundshme që festivali ta përmbushë qëllimin, sepse festivali për Klinën është shumë domethënës, për karakterin dhe cilësinë, duke u bërë tashmë tradicional", është shprehur Elezaj. Edhe drejtuesit e tjerë të festivalit janë shprehur të kënaqur me rrjedhën e festivalit, pjesëmarrjen,

mbarëvajtjen dhe pjesëmarrjen e grupeve, rapsodëve. Drejtori i festivalit Dibran Fylli ka theksuar se janë të impresionuar me pjesëmarrjen që, sipas tij, ishte e paparashikueshme, e bashkë me këtë edhe me numrin e grupeve që përformuan në këtë festival. "Për tri net me radhë në skenën e festivalit u ngjiten këngëtarë, valltarë e instrumentistë nga të gjitha trojet etnike, ku shpalesën vlerat e mirëfillta folklorike kombëtare", është shprehur Fylli. Po ashtu, edhe zyrtarët komunalë kanë dhënë vlerësimet e tyre për organizimin dhe risitë që janë sjellë në këtë festival. Drejtori i Kulturës dhe Sportit, Skender Merturi, ka theksuar se janë përpjekur që festivali t'i arrijë synimet, që edhe është bërë. "Sivjet ka pasur shumë risi, pos aktiviteteve të tjera kulturore e sportive, për tri net ka qëndruar i hapur Panairi me Prodhime Vendore, i organizuar nga Drejtoria Komunale

e Bujqësisë, si dhe është hapur ekspozita e Burim Dushit, me koleksione, nga të më vjetrat të arkeologjisë e lashtësisë", ka thënë Merturi. Gjatë tri netëve sa ka zgjatur festivali janë zhvilluar edhe gara sportive në shumë disiplina sportive, për meshkuj dhe femra, si në futboll, voleyboll, basketboll, hendboll, pingpong, shah e të tjera. Në futboll vendin e parë e ka zënë ekipi "El Trade" që e ka mundur ekipin "B:C. Dibran Hasani" me rezultat 3:2, kurse në paralojë veteranët e UÇK-së kanë fituar kundër QKMF-së. Rexhë Buqani ka theksuar se interesimi ka qenë i madh për të marrë pjesë në turnirët e organizuar në të gjitha disiplinat. "Vetëm në futboll kanë marrë pjesë 29 ekipe, edhe në disiplinat e tjera sportive ka pasur interesim të theksuar. Vendi i parë në futboll ka marrë kupë, medalje e shpërblim në të holla. Edhe për ekipe të tjera janë ndarë mirënjohje", ka thënë Buqani.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SOUTH KOREA - SENEGAL

GG

BELGIUM - COSTA RICA

1

VARNAMO - JONKOPING SODRA

2

Yvesa Islami dhe Redon Qerimi rrëmbejnë medalje në Maqedoni

Gjymnastja Yvesa Islami në disiplinën "Parter", në kategorinë "Yllkat", e ka zënë vendin e parë, ndërsa gjymnasti Redon Qerimi në kategorinë junior është renditur i dyti



PRISHTINE, 10 NËNTOR - Federata e Gjymnastikës e Kosovës (FGJK), pas garës në Itali, ka vazhduar pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare. Këtë herë gjymnastët nga Kosova kanë marrë pjesë në kampionatin shtetëror të Maqedonisë në Gjymnastikën Artistike për Femra dhe Meshkuj, e cila është mbajtur të shtunën në sallën e "KGS PARTIZAN" në Manastir (BITOLA) në Maqedoni. Kjo ishte hera e parë që Kosova merrte pjesë në një garë të tillë me kërkesë të Federatës Evropiane të Gjymnastikës (UEG), me karakter jashtë konkurrence. Sivjet Maqedonia ishte nikoqire e këtij pilotprojekti "FGSRM", kurse në të ardhmen kjo garë do të mba-

het edhe me pjesëmarrjen e Malit të Zi, Shqipërisë dhe Bosnje e Hercegovinës, me qëllim të forcimit dhe zhvillimit të Gjymnastikës në rajon. Garuesit e Kosovës kanë pasur paraqitje të mirë në këtë garë, ku janë përfaqësuar me 13 gjymnastë, derisa në fund nga Federata e Gjymnastikës së Maqedonisë janë shpërblyer me mirënjohje dhe medalje për pjesëmarrje në këtë garë. Federatën e Kosovës e ka përfaqësuar nënkryetarja Elfete Gashi, kurse trajnerë për Gjymnastikë Artistike për Femra ishte Sherife Aliçkaj Qerimi. Ndërsa për Gjymnastikë Artistike për Meshkuj ishin Jetish Hetemi dhe Besnik Latifi.

KOSOVA ËSHTË PËRFAQËSUAR NGA KËTO/A GJYMNASTE/GJYMNASHTË

Gjymnaste

1. Drinesa Qerimi
2. Yvesa Islami
3. Elena Manxholli
4. Lonisa Reka
5. Eljesa Kaçiu
6. Lisa Zeqiri
7. Vilëza Zeqiri
8. Donika Kryemadhi

Gjymnastë

1. Taulant Ramadani
2. Redon Qerimi
3. Elion Viti
4. Dion Mahmutaj
5. Ardi Halili

EKIPI I GJYMNASTEVE - (WOMAN TEAM)

1. Elena Manxholli
2. Vilëza Zeqiri
3. Eljesa Kaçiu
4. Lonisa Reka

SHKURT

Shaqiri i fokusuar vetëm në Botëror

Futbollisti shqiptar Xherdan Shaqiri ka thënë se është i fokusuar vetëm në Kampionatin Botëror "Rusi 2018". Shaqiri nuk arriti ta sigurojë mbijetesën me Stoke Cityn këtë sezon duke nxitur spekulimet se do të ndërrojë ambient, me Liverpoolin e Jurgen Kloppit që i dëshiron shërbimet e tij. "Nuk mund të them asgjë tash. Mendoj se agjenti im kujdeset për të ardhmen time. Jam i fokusuar vetëm te kombëtarja tash", ka thënë Shaqiri.

Arrihet marrëveshja për transferimin e Berishës në Sampdoria

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Valon Berisha, do t'i bashkohet skuadrës së Samporias në Serinë A. Lajmin e ka konfirmuar "Sportitalia", e cila bën me dije se marrëveshja është arritur dhe klubi italian do t'i paguajë Salzburgut, 7 milionë euro, plus 1 milion të tjera bonuse në bazë të performancës. Mesfushori Berisha në 45 ndeshje këtë sezon ka shënuar 13 gola dhe ka bërë 11 asistime.

Neueri: Gjermania është mirë fizikisht

Manuel Neuer ka treguar një formë shumë të mirë gjatë dy ndeshjeve të fundit miqësore. Në Klagenfurt, edhe pse pësoi dy gola, ai u tregua i saktë në disa momente të vështira në portën e tij. Ndaj Arabisë Saudite nuk kishte shumë punë, pasi kundërshtari sulmoi shumë pak në pjesën e parë. "Jemi mirë fizikisht, mund të bënim më tepër, por në fund rezultati foli për ne. Jemi këtu, kemi akoma për të treguar. Kualiteti nuk mungon te skuadra dhe këtë do ta tregojmë në ndeshjen e parë ndaj Meksikës. Duhet të tregohemi më të qetë përpara portës dhe t'i shfrytëzojmë të gjitha rastet që krijojmë", ka thënë Neueri.

Duranti: Basketbolli ma ka shpëtuar jetën

OHIO, 10 QERSHOR - Kevin Durant është pa dyshim protagonist i fitimit të titullit kampion në NBA nga skuadra e Golden State, një basketbollist që ka bërë diferencën në parket

me paraqitjet e tij, duke fituar edhe trofeun MVP të finaleve. "Jam i lumtur, pasi ky sport më ka shpëtuar jetën, jo vetëm mua, por edhe familjes sime. Do t'i jem përjetë mirënjohës

basketbollit", u shpreh Kevin Durant. "Kam shokë skuadre fantastikë dhe jam i lumtur që bëj pjesë në këtë grup. Deri më tani rrugëtimi për mua ka qenë fantastik dhe shpresoj t'i përje-

toj këto emocione edhe në të ardhmen", tha më tej Kevin Durant, që e ka rritur ndjeshëm nivelin e ekipit të Golden State, që kur mbërriti në këtë skuadër dy vjet më parë.



Messi nuk e ndërron "dyshen" me Ligën e Kampionëve

Barcelonë, 10 qershor - Lionel Messi në një intervistë për gazetën katalane "Sport" foli për sezonin e Barcelonës që, pavarësisht se nuk arriti t'i shkonte deri në fund Ligës së Kampionëve, pasi u eliminua në çerekfinale nga

Roma, siguroi triumf të dyfishtë në futbollin spanjoll, duke fituar La Ligën dhe Kupën e Mbretit. "Zhvilluam një sezon të madh, të cilin e mbyllëm me dyshe. Është e vërtetë se ëndrra e të gjithëve është Liga e

Kampionëve, por nuk është nevoja për ta minimizuar sezonin që kemi bërë. Ta fitosh kampionatin dhe Ligën e Kampionëve janë dy gjëra të ndryshme", ka thënë Messi. "Jo, nuk e ndërroj. Gjatë gjithë sezonit kemi humbur

vetëm tre takime, por patëm fatin e keq të eliminohehim nga kompeticioni më emocionues. Ta fitosh La Ligën dhe Kupën e Mbretit është shumë e rëndësishme, pavarësisht asaj që ndodhi në Ligën e Kampionëve".



Seferi dorëzohet përballë Furyt, shkak lëndimi

MANCHESTER, 10 QERSHOR - Boksieri britanik, Tyson Fury, ish-kampion bote në peshën e rëndë, ka fituar me "KO" në raundin e katërt ndaj shqiptarit Seferi, një duel me 10 raunde zhvilluar në Manchester. Kjo ishte sfida e parë pas më shumë se dy vjetësh e gjysmë pushim për Furyn, që rikthehet në ring me misionin për t'i rimarrë titujt kampionë. Dhe në këtë rinisje të aventurës, britaniku nuk zhgënjë, duke korrur fitoren e 26 në karrierën e tij (asnjë humbje), ndërsa Seferi pësoi humbjen e dytë (ka edhe 23 fitore). Një duel midis Davidit dhe Golias, por këtë herë nuk pati surpriza, pasi Fury fitoi pa djersitur shumë ndaj Seferit. Për gati tri raunde, dueli është më shumë qesharak, pa shumë aksion dhe emocione, pasi Fury mendon më shumë t'i argëtojë fansat me veprimet e tij se sa të boksojë, siç është edhe puthja që i dha në buzë Seferit para se të niste dueli. Ndërkohë që, sfida më e bukur duket jashtë ringut, ku ka edhe rrëmujë mes turmës që ndodhet afër ringut, që tërheq edhe vëmendjen e boksierëve. Seferi tenton hera-herës ta sulmojë Furyn, por është më i



shkurtër dhe Fury e mban mirë larg vetes, duke kontrolluar duelin dhe lëshuar ndonjë grusht të fortë, ndërkohë që gjyqtari i fton të jenë më agresivë në ring, raporton "Telesport". Në raundin e katërt Fury nis të jetë më agresiv me grushtet e tij dhe vë në vështirësi Seferin. Edhe pse ky raund mbyllet dhe bëhet gati të nisë raundi i pestë, boksieri shqiptar vendos të mos rikthehet më në ring, pasi nuk është

më në gjendje të duelojë dhe përballë ritmin e forcën e Furyt (u përfol se Seferi është dëmtuar). Gjyqtari ndal ndeshjen dhe Fury fiton me "KO" në raundin e katërt, duke korrur kështu suksesin e parë pas 28 muajsh pushim. "M'u duk sikur debutova edhe një herë në ring. Nuk është faji im që ai u dëmtua. Ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen. Të tjera sfida të mëdha më presin", ka thënë Fury.

Kane: Dua të jem protagonist në Botëror

LONDËR, 10 QERSHOR - Harry Kane ka folur për disa nga gjërat që e kanë inspiruar gjatë karrierës. Sulmuesi, që dy ditë më parë firmosi me Tottenham Hotspur kontratën nga e cila do të fitojë 105 milionë euro për gjashtë vjet, deklaroi se kush ishte sekret i për t'u shndërruar në një nga golashënuesit më të mirë në botë. "Ronaldo 'Fenomeni' është një nga lojtarët që kam ndjekur që fëmijë, edhe pse loja jonë nuk është e ngjashme. Mënyra se si lëvizte dhe shënonte ishte brilante. I shihja në 'Youtube' këto video të tij. Kaloja rreth një orë, duke bërë këtë gjë. E admiroja shumë atë. Shpesh mendoja, teksa e shihja: Ai është një goleador dhe unë dua të bëhem si ai", ka thënë Kane, i cili për sulmuesin anglez Sheringamin ka deklaruar: "Kur fillova të luaja futboll, karriera e tij kishte përfunduar, por kam parë shumë video. Ishte një sulmues i zgjuar. Truri i tij punonte vetëm për futboll. Mendoj se kam



ngjashmëri me atë dhe kështu do të bënim një dyshe të shkëlqyer në fushë. Do të doja shumë të luaja me të". Për Botërorin që fillon pas pak ditësh, Kane ka bërë me dije se synon të jetë protagonist në kampionatin e tij të parë. "Të gjithë do t'i

kenë sytë te ne. Do të jetë një skenar monstruoze. Për mua është kampionati i parë Botëror. Dua të jem protagonist. Jam shumë i emocionuar. Do të ketë shumë nervozizëm dhe tension. Po ne duhet të mundohemi të tregohemi të qetë dhe t'i përballojmë situatat", ka deklaruar Kane.

SHKURT

Golden State mbron titullin kampion në NBA

Golden State Warriors ia ka dalë ta mbrojë titullin kampion në NBA, pasi mposhti bindshëm në finale, 4-0 me ndeshje, Cleveland Cavaliersin. Në "Quicken Loans Arena" të Clevelandit, Warriorsi mori edhe fitoren e fundit me rezultatin 85-108, atë që i duhej për ta mbyllur finalen dhe për t'u shpallur kampionë. Kampionët dominuan sfidën veçanërisht në fraksionin e parë dhe të tretë, ku edhe siguruan distancën nga kundërshtari, ndërsa LeBron Jamesi nuk arriti të dalë në lojën e tij. Ylli i Cavs regjistroi vetëm 23 pikë, 8 asistime dhe 7 rikuperime, teksa u la në hije nga një Stephan Curri i jashtëzakonshëm, me 37 pikë, 4 asistime dhe 6 rikuperime. Kjo ishte finalja e katërt radhazi që shikonte përballë njëra-tjetrës Golden State Warriors dhe Cleveland Cavaliers, me këta të fundit që kanë fituar vetëm një herë dhe kanë humbur 3 të tjerat.

Guardiola: Kurrë më në Barcelonë!

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka thënë se nuk do ta drejtojë më kurrë Barcelonën. "Si trajner, ka marrë fund me Barçën, sepse nuk jam më i njëjti, as ata nuk duken të jenë të njëjtë", ka thënë Guardiola. Ai ka theksuar se në vitin 2008 ka qenë në një moshë fantastike gjatë së cilës e ka pushtuar botën e futbollit me, siç insistoi, lojtarë të jashtëzakonshëm dhe gjeneratë brutale në krye me futbollistin më të mirë në botë, Lionel Messin.

Perezi zëvendëson Lazinin në Botëror

Manuel Lanzini e ka humbur Kupën e Botës pas një lëndimi të pësuar, kurse vendin e tij do ta zë mesfushori i River Plates, Enzo Perez. Ky i fundit e ka fituar duelin në distancë me Diego Perottin, Eric Lamelën dhe Mauro Icardin. Ish-mesfushori i Valencias, tashmë 32-vjeçar, ka luajtur edhe në Botërorin e Brazilit, më 2014-n, kur Argjentina u shpall nënkampione.

Nainggolani kushton 40 milionë euro

Mesfushori belg, Radja Nainggolan, vazhdon të pëlqehet nga ish-trajneri i tij, me të cilin punuan së bashku te Roma, Lucciano Sapelleti. Sipas 'Corriere dello Sport', Roma i ka bërë me dije Interit çmimin e lojtarit. "Giallorosët" nuk e kanë ndërmend të dëgjojnë për ofertat nën 40 milionë euro. Kujtojmë se Nainggolan ka mbetur jashtë Botërorit të Rusisë, duke mos u ftuar nga trajneri i Belgjikës.

Giroudi rrezikon Botërorin

Sulmuesi i Francës, Olivier Giroud, ka pësuar një dëmtim të frikshëm në ndeshjen miqësore që Franca e zhvilloi të shtunën ndaj Amerikës. Në minutën e 55-të sulmuesi i Chelseat u përplas "kokë me kokë" me mbrojtësin e Amerikës, Matt Miazga dhe të dy përfunduan të shtrirë në fushë, sulmuesi francez u detyrua ta fashonte kokën. Të dy lojtarët dolën nga fusha me këmbët e tyre, por pas pak çastesh të dy u zëvendësuan nga trajnerët, për të evituar ndonjë traumë më të rëndë.



RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania „Egzoni” Sh.p.k Piranë, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin e prodhimit të betonit në Piranë, komuna e Prizrenit.

Njoftohet Publiku i Interesuar se me datën 06. 07. 2018. në ora 11:00 ne hapësinat e restorantit „Lisi” afër rrugës Landovicë - Gjonaj në Tupec komuna e Prizrenit., do të organizohet debat publik nga Kompania „Egzoni” Sh.p.k Piranë, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin e prodhimit të betonit në Piranë, komuna e Prizrenit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushë Kosovë. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshohet me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshohet banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

► Lëshohet banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshohet me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshohet banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshohet banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejite



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA “RITMO – L”

**Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333